



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 16/2021 (JR)
Datë 08.04.2021

Vendim nr. 13 (JR)
Datë 04.04.2023

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 04.04.2023, ditën e martë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar, z. Willem Brouwer, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Shkëlqim Mustafa, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 333, datë 13.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 42 dhe 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Shkëlqim Mustafa (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).

2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit *aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Shkëlqim Mustafa*¹, duke konstatuar se: (i) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *nuk ka kryer deklaram të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

2.2. DSIK-ja, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pas përfundimit të procedurave të kryera nga Grupi i Punës për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Shkëlqim Mustafa, në raportin e përcjellë me shkresën nr. {***} prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht², konstaton përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Shkëlqim M. Mustafa.

2.3. KLGj-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në përshkrimin dhe analizimin e tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, të të dhënave e dokumenteve që shoqërojnë formularin sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, të pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të të dhënave nga burimet arkivore të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe, në zbatim të nenit

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 24.04.2018, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë, të deklaratës së pasurisë së subjektit Shkëlqim Mustafa, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë”.

² Me vendimin nr. {***}, datë 24.01.2019, të Komisionit të Deklasifikimit dhe të Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”.

43 të ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar, për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Shkëlqim Mustafa.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, pasi kreu hetimin administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit, arriti në konkluzionet si vijojnë.

3.1. *Nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit u evidentuan problematika lidhur me vlerësimin e pasurisë, nga ku rezultoi se ai ka kryer deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016 dhe se ai nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së tij.*

3.2. *Për kontrollin e figurës, [...] pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së, informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo që të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë e gjen atë të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.*

3.3. *Për vlerësimin e aftësive profesionale, [...] subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe konsiderohet “i aftë”. [...] subjekti i rivlerësimit e ka nivelin minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.*

4. Komisioni, bazuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “c”, si dhe në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, me vendimin nr. 333, datë 13.01.2021, vendosi: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Shkëlqim Mustafa, gjyqtar në Gjykatën të Apelit Tiranë [...].*

III. Shkaqet e ankimit të subjektit i rivlerësimit

5. Kundër vendimit nr. 333, datë 13.01.2021, të Komisionit, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit, duke kërkuar ndryshimin e vendimit objekt shqyrtimi dhe konfirmimin e tij në detyrë. Vendimin e Komisionit, subjekti i rivlerësimit e konsideron të padrejtë, të pabazuar në ligj dhe në prova, si dhe në shkelje të normave për një proces të rregullt ligjor. Subjekti i rivlerësimit e kundërshton këtë vendim dhe i kërkon Kolegjit shqyrtimin në themel të fakteve dhe provave të çështjes.

6. Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale, konsistojnë në sa vijon.

6.1. Nuk plotësohet asnjë nga përcaktimet ligjore të pikave 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që pika 3 e nenit 61 të këtij ligji kërkon vlerësimin bashkërisht të kriterit të vlerësimit të pasurisë me kriterin e

³ *Raportin me nr. {***} prot., datë 27.06.2019, “Për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit”.*

kontrollit të figurës, ndërkohë që për këtë të fundit Komisioni është shprehur pozitivisht.

6.2. Nga katër çështjet që i përkasin kriterit të vlerësimit të pasurisë, të konstatuara me problematika nga Komisioni, duke i klasifikuar në kushtet e përcaktimeve ligjore të nenit 33, pika 5, germat “b”, “c” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016, si dhe nga shqyrtimi i gjashtë çështjeve të tjera po të këtij kriteri, disa prej të cilave të lidhura ngushtë me katër çështjet e para, arrihet lehtësisht në konkluzionin që Komisioni nuk është bazuar dhe nuk ka zbatuar të njëjtat standarde të aplikuara nga Gjykata e Lartë, nga vetë Komisioni në jurisprudencën e tij dhe nga Kolegji, sa i përket “fshehjes së pasurisë”, “deklarimit të rremë/pakujdesisë në deklarim”.

7. Shkaqet e ankimit që i përkasin themelit të çështjes, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, konsistojnë në sa vijon:

7.1. Për pasurinë, apartament me sipërfaqe 88,8 m², i ndodhur në Gjirokastrë:

7.1.1. Përlllogaritja e çmimit të shitjes së banesave, referuar të dhënave të publikuara nga Enti Kombëtar i Banesave (në vijim “EKB”), bëhet vetëm në rastin e mungesës së dokumenteve/provave ligjore për çmimet e shitjes në tregun e lirë. Komisioni mund t’u referohej të dhënave të EKB-së, vetëm në rast se do të kishte konkluduar për pavlefshmërinë e provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.

7.1.2. Vendimet gjyqësore për përpjesëtimin e pasurisë së bashkëshortëve pas zgjidhjes së martesës, konsiderohen prova të paatakueshme, ndryshe nga provat e tjera, siç janë kontratat e shitblerjes apo aktet e ekspertimit për marrje kredie, ku njëra palë apo të gjitha, mund të kenë interesa të ndryshëm në manipulimin e çmimit. Në këto procese gjyqësore, palët nuk kanë interes përveçse përcaktimin e vlerës reale të pasurisë objekt pjesëtimi. Komisioni duket se vetëm i ka përmendur këto vendime gjyqësore, por nuk i ka analizuar, si dhe nuk ka arsyetuar mosmarrjen në konsideratë të tyre, duke theksuar më pas mungesën e paraqitjes së kontratave të ngjashme të shitjes.

7.1.3. Referuar standardit në jurisprudencën e Komisionit dhe Kolegjit, vlerat e çmimit të shitjes së banesave të publikuara nga EKB-ja, janë më të ulëta se vlerat mesatare të përcaktuara në tregun e lirë të banesave. Gjithashtu, sipas standardit të Komisionit për përlllogaritjen e çmimit të shitjes së apartamentit, duhet të ishte marrë në konsideratë dhe duhet të ishte arsyetuar edhe vullneti kontraktor i palëve.

7.1.4. Për amortizimin e mobilieve, konsideruar nga Komisioni “të kahershme”, nuk mund të shtrohet për diskutim, në asnjë variant të mundshëm logjik, çështja e amortizimit të mobilieve të reja, të ardhura nga Greqia, të një cilësie shumë të mirë dhe të përdorura nga subjekti për vetëm 3 vite e gjysmë.

7.1.5. Në rast se qëllimi i kontratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.09.2006, për blerjen nga vjehri në vlerën 3.700.000 lekë, do të kishte qenë kryerja e veprimeve fiktive juridike për fshehjen e pasurisë së paligjshme, atëherë do të ishte më logjike që ndërmjet subjektit dhe shitësit, për shkak të marrëdhënies së posaçme dhe gjendjes financiare të shitësit, të nënshkruhej një kontratë dhurimi dhe jo shitjeje. Për më tepër që blerja e apartamentit përfaqëson një vlerë të konsiderueshme sipas Komisionit, në raport me çmimet e publikuara

nga EKB-ja. Tipologjia e blerjes dhe shitjes së këtij apartamenti nuk përputhet me tipologjinë klasike të kryerjes së veprimeve fiktive për fshehjen e pasurisë së paligjshme.

7.1.6. Komisioni në këtë vendim mban një standard ndryshe, pasi ndërkohë që për shitjen e truallit prej 500 m² pranon faktin që nga viti 1998 deri në vitin 2006, vlera e tij është rritur me rreth 600%, nuk pranon faktin që apartamenti i pozicionuar në qendër të qytetit, të mund të shitet në vlerën e tij reale të tregut (pak më shumë se dyfishi i vlerës së shitjes, të përlogaritur në bazë të çmimeve të publikuara nga EKB-ja).

7.1.7. Çmimi i shitjes së apartamentit në vitin 2010 është më se i logjikshëm dhe nuk mund të konsiderohet në asnjë rast si anomalisht më i lartë, as nëse krahasohet me çmimet e tregut dhe as nëse krahasohet me çmimet e publikuara nga EKB-ja. Vlera e shitjes prej 4.265.508 lekësh, sipas EKB-së, është e njëjtë si për një apartament në periferi, ashtu dhe për një apartament afër qendrës, madje në zonë muzeale. Nëse këtij çmimi do t'i shtohet vlera prej 2.065.729 lekësh, që përfaqëson koston shtesë të punimeve cilësore, si dhe vlerën e mobilimit, diferenca që do të mbetet mes çmimit të shitjes sipas kontratës dhe atij sipas EKB-së, do të ishte 1.838.963 lekë, dhe jo dyfishi si konkluduar nga Komisioni.

7.2. Për pasurinë, apartament me sipërfaqe 126 m², të ndodhur në rr. “{*}”, Tiranë:**

7.2.1. Në vendimin e Komisionit ka mjaftueshëm kontradiktorialitet lidhur me këtë pasuri, sa rrëzohen konkluzionet e tij të ngritura në formë abstrakte.

7.2.2. Analiza e çmimit të shitjes, bazuar në vlerat e publikuara nga EKB-ja, nuk ka asnjë rëndësi, kur në realitet apartamenti nuk është shitur ende as nga i ndjeri B. N. apo familjarët e tij dhe as nga shoqëria ndërtuese “{***}” ShPK. Çmimi i apartamentit nuk do të jetë në vlerën e përlogaritur sipas EKB-së, por shumë herë më i lartë.

7.2.3. Komisioni është i paqartë në lidhje me vlerën e kaparit që subjekti i rivlerësimit duhet t'i jepte ish-pronarit të truallit me premtimin për shitjen e një apartamenti që do të përfitohej pas ndërtimit të një pallati në truallin e tij, nëse duhet të jepte më shumë hua se 28.000 euro, dhe nëse ka çmime reference për dhënie kapari.

7.2.4. Nuk mund të nënshkruhet një kontratë shitblerjeje në kushtet e një situatë të paqartë juridike, siç është ajo e konfliktit gjyqësor, mes z. B. N. dhe shoqërisë ndërtuese dhe, për pasojë, bllokimit të transaksioneve për këtë pasuri. Në përfundim të procesit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit rrezikon të mos nënshkruajë një kontratë shitblerjeje me pronarin e këtij apartamenti banimi, cilido qoftë ai, e në rastin më të mirë, mund të marrë mbrapsht shumën e dhënë “hua” prej 28.000 eurosh.

7.2.5. Konkluzioni i Komisionit për fshehjen e vlerës reale të blerjes së apartamentit, mbështetet vetëm në aludime. Subjekti i rivlerësimit është i paqartë për përfitimin që ai mund të ketë, në përfundim të “skemës” së fshehjes së pasurisë të paligjshme, si arsyetuar nga Komisioni. Është i pakuptueshëm fakti i përfitimit të apartamentit për të cilin ka paguar minimalisht vlerën 16.698.120 lekë, pa pasur një dokument pronësie, dhe të vazhdojë të jetojë me “vetëbesimin” që si familjarët “N.”, ashtu edhe shoqëria ndërtuese, pasi të kenë zgjidhur konfliktin gjyqësor, do të lejojnë të banojë aty, pa tentuar ta shesin apartamentin për përfitimin e tyre.

7.2.6. Përtej tendencës në keqinterpretim, nuk është e qartë se si e konsideron Komisioni mosnënshkrimin ende nga subjekti i rivlerësimit, të një kontrate shitblerjeje për apartamentin, për shkak se nuk është përcaktuar pronari i tij, si një “fshehje e pasurisë së paligjshme” apo si një “pamundësi objektive”. Në kushtet e paqartësisë juridike, askush nuk do të nënshkruante një kontratë shitblerjeje apo të deklaronte si pasuri një apartament për të cilin nuk ka siguri edhe për sa kohë do të vijojë të qëndrojë në të.

7.2.7. Konkluzionet e Komisionit, bazë e shkarkimit nga detyra, nuk janë të bazuara në asnjë provë dhe shkojnë përtej rrjedhës normale të logjikës, pasi lidhja e një kontrate shitblerjeje për një pasuri të paluajtshme me një person që nuk gëzon statusin e pronarit të pasurisë objekt kontrate, prodhon efektin juridik të pavlefshmërisë absolute.

7.3. Për pasurinë, automjet “Mercedes Benz”, tip “ML 350 CDI 4MATIC”:

7.3.1. Pretendimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues se cili është pronar i automjetit, është absurd. Edhe pse z. I. M. është zhvendosur në Mbretërinë e Bashkuar, pronësia nuk humbet, pavarësisht ndodhjes së pronarit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në këto kushte, z. I. M. vazhdon të jetë dhe aktualisht pronar i këtij automjeti.

7.3.2. Mbi aftësinë paguese të z. I. M. dhe z. B. M., subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision dokumentacion për të vërtetuar se këta individë kanë pasur mundësi të blejnë jo vetëm këtë automjet, por edhe disa automjete të tjera.

7.3.3. Ndryshe nga sa konstaton Komisioni në vendim, bazuar në të dhënat e sistemit TIMS, evidentohet qartë se z. I. M. ka kaluar 6 herë kufirin e Republikës së Shqipërisë me këtë automjet.

7.3.4. Mosdeklarimi i përdorimit të automjetit në deklaratat periodike vjetore dhe deklaratën e pasurisë *vetting*, vjen pasi detyrimi për deklarimin e përdorimit të sendeve të paluajtshme/luajtshme jo në pronësi, hyri në fuqi vetëm pas ndryshimeve të bëra përmes ligjit nr. 42/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 85, datë 21.04.2017. Përdorimi i automjetit nuk është deklaruar as në deklaratën e pasurisë *vetting*, e cila u plotësua përpara hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve ligjore. Për këtë arsye, konkluzionet e Komisionit nuk qëndrojnë dhe nuk përputhen me realitetin e kuadrit përkatës rregullator.

7.3.5. Në lidhje me dyshimet se ky automjet është pasuri e subjektit të rivlerësimit, Komisioni vendos një standard, sipas të cilit çdo subjekt rivlerësimi që është i pajisur me një autorizim për përdorimin e një automjeti në pronësi të familjarëve të tij, do të akuzohet automatikisht se ka fshehur këtë pasuri, e që në të vërtetë nuk është përdorues, por pronar i saj. Blerja e këtij automjeti në Gjermani është larg standardit ekonomik të subjektit, i cili deklaron se vazhdon ta përdorë dhe mirëmbajë automjetin tip “Benz 2011” të blerë në vitin 2010, e nëse do të donte të blinte një automjet të ri, fillimisht do të kishte shitur atë që dispononte.

7.3.6. Komisioni nuk ka zbatuar standardet e jurisprudencës së tij se – në vlerësimin e

ekzistencës ose jo të fshehjes së pasurisë, duhet të merret në konsideratë edhe sjellja/qëndrimi i subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit – në rastin kur subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme për krijimin e pasurisë objekt pasaktësie, ajo do të konsiderohet pakujdesi në plotësimin e deklaratave dhe jo fshehje/mosdeklarim me pasoja për subjektin e rivlerësimit.

7.4. Për analizën financiare 2003 – 2016, balanca negative në vlerën 752.488 lekë, nuk përbën shkak për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit dhe Komisioni duhet të zbatonte të njëjtin standard si në jurisprudencën⁴ e tij.

I. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Shkëlqim Mustafa, vendim të cilin, nëpërmjet ankimit, subjekti kërkon ta ndryshojë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

9. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh, nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

10. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 333, datë 13.01.2021, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit, z. Shkëlqim Mustafa, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi.

⁴ Vendimi nr. 20, datë 04.06.2018; vendimi nr. 99, datë 14.01.2019; vendimi nr. 161, datë 18.04.2019; vendimi nr. 183, datë 19.07.2019; vendimi nr. 185, datë 23.07.2019; vendimi nr. 188, datë 24.07.2019; vendimi nr. 217, datë 05.12.2019 etj.

11. Trupi gjykues i Kolegjit, për të konkluduar mbi formën e gjykimit të çështjes, si dhe për të evidentuar shkelje procedurale që do të cenonin procesin e rregullt ligjor të sanksionuar në nenin 42, pika 2 e Kushtetutës dhe nenin 6, paragrafi 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, analizoi fillimisht shkaqet e ankimit me natyrë procedurale të ngritura nga subjekti i rivlerësimit.

11.1. Lidhur me pretendimin se subjekti i rivlerësimit nuk ndodhet në asnjë nga përcaktimet ligjore të pikave 1 dhe 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 për shkarkimin e tij nga detyra dhe se pika 3 e nenit 61⁵ të ligjit, kërkon vlerësimin bashkërisht të kriterit të kontrollit të figurës me atë të vlerësimit të pasurisë, ndërkohë që për kriterin e figurës Komisioni është shprehur pozitivisht, trupi gjykues vlerëson se Kolegji tashmë ka një qëndrim të konsoliduar e të shtjelluar në detaj në jurisprudencën e tij, në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Pavarësisht se deklarimi i pamjaftueshëm i pasurisë dhe i figurës janë parashikuar në normimin ligjor të pikës 3 të nenit 61, bazuar në përcaktimet e neneve D dhe Dh të Aneksit të Kushtetutës për këto dy kriteret, nuk mund të pretendohet se aplikimi i tyre duhet të interpretohet në mënyrë kumulative. Përcaktimet e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, nuk kërkojnë domosdoshmërisht vlerësimin për të dy kriteret bashkërisht për të konkluduar që subjekti i rivlerësimit gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm. Po ashtu interpretohen përcaktimet e këtij neni në raport me ato të nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, të cilat për konfirmimin në detyrë të subjektit, kërkojnë plotësimin së bashku të kushteve për të tria kriteret e rivlerësimit, ndërsa nëse subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, edhe pse vlerësimi për dy kriteret e tjera është pozitiv, institucionet e rivlerësimit japin masën disiplinore të shkarkimit nga detyra. Për këto arsye, trupi gjykues e vlerëson pretendimin e subjektit të rivlerësimit, të pabazuar.

11.2. Lidhur me pretendimin se, nga katër çështjet që i përkasin kriterit të vlerësimit të pasurisë, të konstatuara me problematika nga Komisioni, duke i klasifikuar në kushtet e përcaktimeve ligjore të nenit 33, pika 5, gerrat “b”, “c” dhe “ç” të ligjit nr. 84/2016, si dhe nga shqyrtimi i gjashtë çështjeve të tjera po të këtij kriteri, disa prej të cilave të lidhura ngushtë me katër çështjet e para, arrihet lehtësisht në konkluzionin që Komisioni nuk është bazuar dhe nuk ka zbatuar të njëjtat standarde të aplikuara nga Gjykata e Lartë, nga vetë Komisioni në jurisprudencën e tij dhe nga Kolegji, sa i përket “fshehjes së pasurisë”, “deklarimit të rremë/pakujdesisë në deklaram”, trupi gjykues vlerëson se në kushtet kur kjo çështje e juridiksionit të rivlerësimit i nënshtrohet shqyrtimit në Kolegji, do të trajtohet mbështetur në jurisprudencën e tij, në përputhje me parimin mospërkeqësimit të pozitës së subjektit të rivlerësimit (no reformatio in peius).

12. Duke u bazuar në parashikimet e neneve 47 dhe 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), subjekti i rivlerësimit më datë 24.01.2023, paraqiti në Kolegji parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, si dhe kërkoi administrimin në cilësinë e provës të akteve shkresore, që lidhen me tri çështjet që do të trajtohen në këtë vendim, konkretisht me:

⁵ Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 24, datë 10.11.2006, në të cilin shprehet se: “Prania e domosdoshme e të dy elementeve, rezulton edhe nga analiza gjuhësore e tekstit të nenit 101 të Kushtetutës. Lidhëza “dhe”, si në çdo rast, kërkon praninë e njëkohshme të të dy elementeve, në dallim nga rastet e tjera kur në dispozitën ligjore janë përdorur lidhëset “ose”/“apo””.

a) çmimin e shitjes së apartamentit me sipërfaqe 88,8 m² në Gjirokastrë, në vitin 2010; b) pasurinë, apartament me sipërfaqe 126 m², në Tiranë; c) përdorimin e automjetit “Mercedes Benz”, tip “ML 350 CDI 4MATIC”.

12.1. *Mbi çmimin e shitjes së apartamentit me sipërfaqe 88,8 m² në Gjirokastrë, në vitin 2010:*

i. Shkresë nr. {***} prot., datë 12.01.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Gjirokastrë, me të cilën vihet në dispozicion kontrata e kredisë bankare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.06.2008, pjesë e fashikullit të prokurorisë, me të pandehur H. D.. Me këtë kontratë, është lëvruar kredia në masën 57.500 euro, për garantimin e së cilës është nënshkruar dhe kontrata e hipotekimit nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.06.2008, me objekt apartamentin me sipërfaqe 108,5 m², në Gjirokastrë.

ii. Shkresë nr. {***} prot., datë 18.01.2023, e Bankës Kombëtare Tregtare ShA, me të cilën përcillen tri raporte vlerësimi të pasurive të paluajtshme në qytetin e Gjirokastrës, në periudhën 2009-2011, përgatitur për këtë bankë për efekt dhënie kredie, nga inxhinierë të licencuar për vlerësim pasurish të paluajtshme:

1) raport vlerësimi i datës 05.11.2009, për apartamentin me sipërfaqe 63 m², ndodhur në lagjen “{***}”, vlerësuar 4.600.000 lekë;

2) raport vlerësimi i datës 28.09.2010, për apartamentin me sipërfaqe 89 m², ndodhur në lagjen “{***}”, vlerësuar 4.800.000 lekë;

3) raport vlerësimi i datës 28.02.2011, për apartamentin me sipërfaqe 62 m², ndodhur në lagjen “{***}”, vlerësuar 7.200.000 lekë.

iii. Shkresë, datë 12.01.2022, e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Gjirokastrë, me të cilën përcillet raporti i rivlerësimit i datës 20.10.2011, për apartamentin e banimit me sipërfaqe 100,2 m², ndodhur në lagjen “{***}”, Gjirokastrë, vlerësuar 70.000 euro (9.989.000 lekë).

12.2. *Për pasurinë, apartament me sipërfaqe 126 m², në Tiranë:*

i. Vërtetim, datë 20.01.2023, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për regjistrimin e çështjes administrative nr. {***}, datë 30.09.2022, me palë ndërgjyqëse: paditës O. N., i paditur D. P., me objekt: *1. Kundërshtohet vendimi i noteres D. P. “Për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të testamentit nr. {***}, datë 31.12.2017, të testatorit B. N., përpiluar me aktin noterial nr. rep. {***}, nr. kol. {***}, datë 05.05.2022 [...].*

12.3. *Për përdorimin e automjetit “Mercedes Benz”, tip “ML 350 CDI 4MATIC”:*

i. Shkresë nr. {***} prot., datë 16.01.2023, e Komisarariatit të Policisë Pukë, mbi hyrje-daljet e z. B. M..

ii. Njoftim i tarifës së gjobës nr. {***}, lëshuar nga “London Borough of Southwark Parking Services”, vendndodhja e kundërvajtjes: {***}, datë 12.10.2022, për automjetin me targë {***}, në emër të z. B. M..

iii. Njoftim i tarifës së gjobës nr. {***}, lëshuar nga Këshilli i Manchester City, Shërbimet e Parkimit, vendi “{***}, më 02.01.2023, për automjetin me targë {***}, në emër të z. B. M..

iv. Njoftim për tarifën e gjobës nr. {***}, lëshuar nga “London Borough of Bexley”, data e kundërvajtjes 28.12.2022, vendndodhja {***}, për automjetin me targë {***}, në emër të z. B. M..

13. Kolegji, kërkesën e subjektit të rivlerësimit, e shqyrtoi në këndvështrimin e dispozitës ligjore që përlligj pranimin e provave të reja në gjykimin administrativ të apelit, konkretisht nenit 47⁶ të ligjit nr. 49/2012. Nga analizimi i këtyre akteve shkresore, trupi gjykues vlerëson se për aktet që lidhen me çmimin e shitjes së apartamentit me sipërfaqe 88,8 m² në Gjirokastrë, në vitin 2010, subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë që ka qenë në pamundësi për depozitimin e tyre gjatë hetimit administrativ në Komision, gjë që vërtetohet nga të dhënat e kontratës së kredisë bankare dhe raporteve të vlerësimit/rivlerësimit, të prodhuara në vitet 2008 - 2011. Ndërsa, për aktet shkresore që provojnë veprime të kryera pas dhënies së vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vlerëson se: i) vërtetimi, datë 20.01.2023, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, për çështjen administrative nr. {***}, datë 30.09.2022, me palë ndërgjyqëse: paditës O. N., i paditur D. P., është i panevojshëm dhe i parëndësishëm për vendimmarrjen e Kolegjit, në kuptim të nenit 49, pika 6, gjerat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016. Bazuar në të njëjtat përcaktime të kësaj dispozite ligjore, u vlerësuan dhe aktet lidhur me përdorimin e automjetit me targë {***}.
14. Në këto kushte, trupi gjykues e gjeti të pambështetur në fakte dhe në parashikimet e nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, kërkesën për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike e për marrjen në cilësinë e provës të akteve shkresore të sipërcituara dhe vendosi që sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, të shqyrtojë çështjen e juridiksionit të rivlerësimit nr. 16/2021, datë 08.04.2021, mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi.

B. Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë

15. Për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 88,8 m², ndodhur në Gjirokastrë, subjekti i rivlerësimit në ankim, paraqet këto shkaqe ankimore: (i) *Përlllogaritja e çmimit të shitjes së banesave, referuar të dhënave të publikuara nga EKB-ja, bëhet vetëm në rastin e mungesës së dokumenteve/provave ligjore për çmimet e shitjes në tregun e lirë. Komisioni mund t’u referohej të dhënave të EKB-së, vetëm në rast se do të kishte konkluduar për pavlefshmërinë e provave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit.* (ii) *Vendimet gjyqësore për përpjesëtimin e pasurisë së bashkëshortëve pas zgjidhjes së martesës, konsiderohen prova të paatakueshme, ndryshe nga provat e tjera, siç janë kontratat e shitblerjes, apo aktet e ekspertimit për marrje kredie, ku njëra palë apo të gjitha mund të kenë interesa të ndryshëm në manipulimin e çmimit. Në këto procese gjyqësore, palët nuk kanë interes, përveçse përcaktimin e vlerës reale të pasurisë objekt pjesëtimi. Komisioni duket se vetëm i ka përmendur këto vendime gjyqësore, por nuk i ka analizuar, si dhe nuk ka arsyetuar mosmarrjen në konsideratë të tyre, duke*

⁶ Neni 47 i ligjit nr. 49/2012, parashikon: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

theksuar më pas mungesën e paraqitjes së kontratave të ngjashme të shitjes; iii. Referuar standardit në jurisprudencën e Komisionit dhe Kolegjit⁷, vlerat e çmimit të shitjes së banesave të publikuara nga EKB-ja, janë më të ulëta se vlerat mesatare të përcaktuara në tregun e lirë të banesave. Gjithashtu, sipas standardit⁸ të Komisionit për përllogaritjen e çmimit të shitjes së apartamentit duhet të ishte marrë në konsideratë dhe duhet të ishte arsytuar edhe në lidhje me vullnetin kontraktor të palëve. (iii) Për amortizimin e mobilieve, konsideruar nga Komisioni “të kahershme”, nuk mund të shtrohet për diskutim, në asnjë variant të mundshëm logjik, çështja e amortizimit të mobilieve të reja, të ardhura nga Greqia dhe të një cilësie shumë të mirë, të përdorura nga subjekti për vetëm 3 vite e gjysmë; iv) Çmimi i shitjes së apartamentit në vitin 2010 është më se i logjikshëm dhe nuk mund të konsiderohet në asnjë rast si anomalisht më i lartë as nëse krahasohet me çmimet e tregut dhe as nëse krahasohet me çmimet e publikuara nga EKB. Vlera e shitjes prej 4.265.508 lekë sipas EKB-së, është e njëjtë si për një apartament në periferi ashtu dhe për një apartament afër qendrës madje në zonë muzeale. Nëse këtij çmimi do t’i shtohet vlera prej 2.065.729 lekë që përfaqëson koston shtesë të punimeve cilësore, si dhe vlerën e mobilimit, diferenca që do të mbetet mes çmimit të shitjes sipas kontratës dhe atij sipas EKB-së do të ishte 1.838.963 lekë dhe jo dyfishi si konkluduar nga Komisioni. Në analizë të këtyre pretendimeve, trupi gjykues konstaton:

15.1. Komisioni ka vlerësuar se çmimi i shitjes së këtij apartamenti, dy herë më i lartë se ai i blerjes, për më tepër me sende e orendi “të kahershme”, të cilat logjikisht duhet të ishin amortizuar dhe pa asnjë investim të kryer ndër vite, është përtej logjikës ekonomike. Veprimet e subjektit të rivlerësimit, në tërësinë e tyre, si blerja në vitin 2006, burimi i të ardhurave për blerjen, apo shitja në vitin 2010 e përdorimi i të ardhurave nga shitja, të krijojnë bindjen se janë një sërë veprimesh *fiktive* të kryera nga subjekti i rivlerësimit, me qëllim justifikimin e pasurive të përfituara prej tij, duke e vendosur atë në kushtet e një deklarimi të rremë lidhur me këtë pasuri, në kuptim të germës “ç” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

15.2. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues konstaton se në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi apartament me sipërfaqe 88,8 m², Gjirokastër, blerë në shumën 3.700.000 lekë, me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.09.2006. Burim krijimi, subjekti deklaroi të ardhurat nga shitja e truallit me sipërfaqe 500 m², ndodhur te “{***}”, Gjirokastër, si dhe kredinë e marrë nga Alpha Bank ShA, më datë 09.10.2006, në vlerën 3.000.000 lekë. Ky apartament banimi është shitur në vlerën 60.000 euro, me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.08.2010. Nga vlera e shitjes, është shlyer totalisht kredia bankare në muajin prill 2010, në vlerën 2.410.583 lekë.

15.3. Përfitimin e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në deklaratën periodike vjetore përkatëse, atë të vitit 2006, si vijon: *blerje apartamenti 2+1 me sipërfaqe 88 m², lagjja “{***}”, Gjirokastër, në vlerën 3.700.000 lekë, pjesa takuese 100%. Po në këtë deklaratë, subjekti deklaroi: Shitje e truallit të deklaruar më parë, lagjja “{***}”, Gjirokastër, në vlerën 1.000.000 lekë, si dhe në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”,*

⁷ Vendimi nr. 34, datë 02.12.2019, paragrafi 67.1, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit; vendimi nr. 308, datë 14.10.2020, pikat 2 dhe 2.1; vendimi nr. 303, datë 05.10.2020, pjesa II, germa “A”, nëngerma “A/2”, pika 1; vendimi nr. 302, datë 02.10.2020, pjesa IV, germa “A”, nëngerma “A/2”, pika 1, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

⁸ Shih vendimin nr. 261, datë 16.06.2020, pjesa IV, pika 1.8, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

deklaron: *Marrje kredie për blerje shtëpie në Alpha Bank, më 09.10.2006, në vlerën 3.000.000 lekë.*

15.4. Sa i përket origjinës së apartamentit objekt shqyrtimi, ai rezulton të jetë blerë nga E. F. (vjehtëri i subjektit të rivlerësimit), me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 14.12.2002, në gjendje karabina nga Z., I., A., K. dhe A. T., në vlerën 700.000 lekë⁹. Më pas, nëpërmjet kontratës për shitje pasurie të patundshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.09.2006, ky apartament tjetërsohet te blerësi Shkëlqim Mustafa, në vlerën 3.700.000 lekë. Referuar kushteve të kontratës, shuma prej 700.000 lekësh është likuiduar ditën e nënshkrimit të kontratës, ndërsa diferenca prej 3.000.000 lekësh do të likuidohet në momentin e lëvrimin të kredisë nga Alpha Bank ShA. Trualli, të ardhurat nga shitja e të cilit kanë shërbyer si një nga burimet për blerjen e apartamentit, nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se është blerë me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.04.1998, në vlerën 150.000 lekë, dhe është shitur 8 vjet më vonë, nëpërmjet kontratës së shitjes së pasurisë së patundshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.07.2006, në vlerën 1.000.000 lekë. Nga dokumentacioni i depozituar me deklaratën e pasurisë *vetting*, konkretisht nga lëvizja e llogarisë bankare të përbashkët të subjektit dhe bashkëshortes, pranë kësaj banke rezulton se kredia prej 3.000.000 lekësh është disbursuar më 18.10.2006 dhe më datë 27.10.2006, kjo shumë është transferuar te shitësi E. F., me përshkrimin: *Blerje apartamenti me kusht nga Shkëlqim Mustafa tek E. F. sipas kontratës.*

15.5. Pas 4 vitesh, me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.08.2010, subjekti i rivlerësimit, këtë apartament ua shet z. E. H. dhe znj. L. H., në vlerën 60.000 euro, shumë e cila është likuiduar: (i) kësti i parë 30.000 euro në datën 02.04.2010; dhe (ii) kësti i dytë 30.000 euro, ditën e nënshkrimit të kontratës. Në këtë kontratë citohet se shitësi me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, deklaron se këtë pasuri e shet te blerësit me të gjitha pajisjet shtëpiake, për të cilat blerësit nuk kanë pasur asnjë pretendim për gjendjen e tyre fizike. Këtë transaksion dhe përdorimin e shumës së përfituar prej tij, subjekti i rivlerësimit i deklaron në deklaratën e interesave private të vitit 2010. Po në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit deklaron shlyerjen totalisht të kredisë së marrë në Alpha Bank ShA në prill 2010, shuma e paguar 2.410.583 lekë, me të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit të banimit në Gjirokastrë, kohë që korrespondon dhe me përfitimin e kështit të parë të shitjes së apartamentit.

15.6. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Gjirokastrë, nëpërmjet shkresës nr. {***} prot., datë 14.08.2020, drejtuar Komisionit në kuadër të hetimit administrativ dhe shkresës nr. {***} prot., datë 18.02.2020, drejtuar subjektit të rivlerësimit, informon se për pasuritë e tjetërsuara nga subjekti i rivlerësimit, qoftë kjo truall me sipërfaqe 500 m², qoftë apartament me sipërfaqe 88,8 m², është paguar detyrimi financiar për kalimin e pronësisë, konfirmuar respektivisht sipas mandatarkëtimit nr. {***}, datë 20.07.2006, në shumën 5.000

⁹ Përveç kësaj kontrate, subjekti i rivlerësimit depoziton dhe 3 (tri) kontrata (1. kontratë shitje pasurie e paluajtshme – apartament nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.10.2002; 2. kontratë shitje pasurie e paluajtshme – apartament nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.09.2002; 3. kontratë shitje pasurie e paluajtshme – apartament nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.10.2002) për transaksione të tjera nga e njëjta palë shitëse, për apartamente në të njëjtën godinë në gjendje karabina, për të cilat rezulton gjithashtu i njëjti çmim.

lekë, me përshkrimin: *tatim shitje 0,5% e vlerës 1.000.000 lekë, nr. {***} rep., nr. {***} kol., dhe sipas mandatarkëtimit të Bankës Popullore, datë 26.08.2010: Urdhëruesi ZVRPP Gjyrokastër, tatim shitje sipas kontratës nr. {***} kol., nr. {***} rep., datë 23.08.2010, Shkëlqim Mustafa, shuma 442.000 lekë, që përbën 10% të diferencës mes çmimit të shitjes 8.118.000 lekë dhe çmimit të blerjes 3.700.000 lekë.*

15.7. Gjatë hetimit administrativ, lidhur me blerjen e apartamentit në vlerën 3.700.000 lekë dhe shitjen e tij në vlerën 60.000 euro, gati dyfishin e vlerës së blerjes, dhe paraqitjen e kontratave të ngjashme, subjekti i rivlerësimit, me përgjigjet e pyetësorëve dhe prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ, ka sqaruar se kur është blerë apartamenti, ka qenë i mobiluar tërësisht nga vëllai i bashkëshortes, në çdo element funksional të tij. Mobilimi me investimet e kunatit, me të ardhura të krijuara në Greqi, është kryer pak përpara blerjes prej tij, ndaj, sipas subjektit të rivlerësimit, dhe çmimi i blerjes përfaqëson jo vetëm apartamentin, por edhe arredimin dhe orenditë brenda tij. Ndërsa për çmimin e shitjes në vitin 2010, subjekti i rivlerësimit sqaron se është bazuar plotësisht në parimet e përgjithshme të tregut që aplikohen në zonën përkatëse dhe që mbështeten në kriteret e tilla, si: vendndodhja, destinacioni i përdorimit, orientimi, sipërfaqja dhe gjendja e pronës. Çmimi i tregut të apartamenteve për atë periudhë, sipas subjektit, varionte në 500 euro/m². Apartamenti ishte tërësisht i mobiluar dhe blerësi mund të banonte menjëherë, pa pasur nevojë që të shtonte asgjë. Diferenca e çmimit të shitjes, sipas subjektit, ishte rezultat i një rritjeje natyrale të çmimeve të banesave në të gjithë vendin, përfshirë dhe Gjyrokastër, tendencë që shihet edhe në të dhënat e Institutit të Statistikave. Subjekti i rivlerësimit përmend dhe arsye të tjera, si: mungesa e trojeve në një territor të caktuar, rritja e çmimeve të lëndëve të para, rritja e çmimit të fuqisë punëtore, rritja e detyrimeve tatimore për ndërtimet e reja.

15.8. Lidhur me vlerën e investimeve në këtë apartament, që ka ndikuar dhe rritjen e vlerës së tij, gjatë hetimit administrativ në Komision dhe në ankim, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se ky apartament është blerë nga vjehri për llogari të djalit të tij K. F., me qëllim që të përdorej si banesë nga ky i fundit, i cili punonte në Athinë që nga fillimi i vitit 1991, në fushën e duralumineve, dhe vazhdimisht ka kryer aktivitete në qytetin e Gjyrokastër. Z. K. F. e ka blerë dhe ka investuar në këtë apartament pasi ka menduar të qëndrojë në të dhe të ushtrojë aktivitetin tregtar në qytetin e Gjyrokastër. Cilësia e punimeve dhe e mobilimit, sipas subjektit të rivlerësimit në ankim, kanë qenë në nivel maksimal, si pasojë e faktit që z. K. F. ishte biznesmen i suksesshëm në Greqi, me ortakë shtetas grekë. Cilësia e lartë e punimeve të bëra pa nxitim dhe ndër vite, për periudhën 2002 – 2006, nuk krahasoheshin me cilësinë e punimeve që mund të bëheshin nga shoqëria ndërtimore. Ndërkohë që z. F. kishte një projekt tjetër dhe donte ta shiste, këtë banesë e bleu subjekti i rivlerësimit.

15.9. Referuar të dhënave të tregut të lirë të shitjes së apartamenteve, sipas përcaktimeve në udhëzimin nr. 5, datë 7.9.2006, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave dhe të koeficientit “K” për vitin 2006”, në qytetin e Gjyrokastër çmimi i apartamenteve ka qenë 39.034 lekë/m², dhe me këtë përlllogaritje, vlera e tregut për apartamentin objekt shqyrtimi, rezulton 3.466.219 lekë, ndërkohë që është blerë nga subjekti në vlerën 3.700.000 lekë. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen pa efekt në arsyetimin e tij lidhur me këtë pasuri, pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nëse qëllimi i blerjes së apartamentit nga vjehri, në vlerën 3.700.000 lekë, do të kishte qenë

kryerja e veprimeve fiktive juridike për fshehjen e pasurisë së paligjshme, atëherë do të ishte më logjike që ndërmjet subjektit dhe shitësit, për shkak të marrëdhënies së posaçme dhe gjendjes financiare të shitësit, të nënshkruhej një kontratë dhurimi dhe jo shitjeje. Argumenti i subjektit të rivlerësimit nuk ka relevancë në qëndrimin e trupit gjykues, pasi nëse kjo pasuri do të ishte përfituar nëpërmjet kontratës së dhurimit, përsëri do t'i nënshtrohej një regjimi tjetër kontrolli sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016¹⁰.

15.10. Lidhur me çmimin e shitjes prej 60.000 eurosh, që sipas subjektit të rivlerësimit përbën çmimin real të shitjes së apartamentit, me gjithë mobilim, gjatë hetimit administrativ në Komision, subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar kontrata të ngjashme, me pretendimin se palët kontraktore vendosin çmime shumë të ulëta për të shmangur detyrimet tatimore, fenomen që ndodh rëndom në Shqipëri. Në hierarkinë e provave ligjore për vërtetimin e çmimit real të shitjes në treg të një apartamenti, mund të paraqiten, sipas subjektit të rivlerësimit, vendime gjyqësore dhe aktet e ekspertimit në lidhje me kërkesëpaditë për pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore pas zgjidhjes së martesës, të cilat konsiderohen prova të paatakueshme, pasi ndryshe nga provat e tjera, siç janë kontratat e shitblerjes apo aktet e ekspertimit për marrje kredie, ku njëra palë apo palët mund të kenë interesa të ndryshëm për të manipuluar çmimin, në rastin e këtyre proceseve gjyqësore, palët kanë interes përcaktimin e vlerës reale të tregut të pasurisë objekt pjesëtimi.

15.11. Vendimet gjyqësore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në mbështetje të pretendimit të tij mbi një çmim real në shitjen e apartamentit, janë dy vendime të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, konkretisht: (i) vendim¹¹, me objekt pjesëtimin e sendit në bashkëpronësi, në të cilin apartamenti me sipërfaqe 112 m², i ndodhur në lagjen “{***}”, Gjirokastër, është vlerësuar 6.581.366 lekë; (ii) vendim¹², po me objekt pjesëtim pasurie, në të cilin apartamenti me sipërfaqe 104 m², i ndodhur në lagjen “{***}”, Gjirokastër, në një pallat të ri të ndërtuar në vitin 2006-2007, ku sipas ekspertes, është bërë vlerësimi sipas çmimit të referencës në shumën 4.135.664 lekë dhe sipas çmimit të tregut, është vlerësuar 50.000 euro, për të cilin palët në proces, me pohimet e tyre, u shprehën se është varianti më i mundshëm dhe i përshtatshëm.

15.12. Ashtu siç pretendon dhe subjekti i rivlerësimit në ankim, duket se Komisioni në paragrafin 2.18.1 të vendimit¹³, i ka përmendur këto vendime gjyqësore, por nuk ka arsyetuar më tej mbi vlerën provuese të tyre, në drejtim të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit. Nga analizimi i këtyre vendimeve gjyqësore, trupi gjykues nuk konstaton që vlera e përcaktuar për pasuritë e paluajtshme objekt i këtyre vendimeve gjyqësore, të jetë e njëjtë me atë të transaksionit të kryer nga subjekti i rivlerësimit, për faktin se vlerësimi i tyre është bërë në

¹⁰ Neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, parashikon: “Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”.

¹¹ Vendimi nr. {***}, datë 15.05.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, lënë në fuqi me vendimin nr. {***}, datë 29.10.2015, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër.

¹² Vendimi nr. {***}, datë 11.05.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër.

¹³ Në vendimin nr. 333, datë 13.01.2021, të Komisionit, në paragrafin 2.18.1, citohet: “2.18.1 Subjekti paraqet në shpjegimet e tij dy vendime gjyqësore, që tregojnë çmimin real të pasurive. Këto vendime gjyqësore kanë pasur për objekt pjesëtimin e pasurisë bashkëshortore dhe ekspertët e gjykatës kanë vlerësuar për apartamentet me sipërfaqe të përafërta dhe në zona edhe më të dobëta se pallati i tij, një vlerë të përafërt me shitjen që ka bërë”.

vitin 2015, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit e ka tjetërsuar apartamentin në vitin 2010, pra 5 vite më herët, vendndodhja është e ndryshme, sipërfaqja e pasurive të paluajtshme objekt pjesëtimi pasuror është më e madhe (16 – 24 m²) nga sipërfaqja e pasurisë së shitur nga subjekti i rivlerësimit, po ashtu dhe çmimi i referuar në to, duket se provon bazueshmërinë e vendimit të Komisionit për shkak të informacionit që sjellin. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se këto vendime gjyqësore nuk mbështesin pretendimet e subjektit të rivlerësimit.

15.13. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit sqaron se u është drejtuar bankave të nivelit të dytë, me qëllim marrjen e ekspertimeve të kryera prej tyre për efekt dhënie kredie për blerje apartamenti, në vitet 2009-2011, por nuk i janë vënë në dispozicion, me pretendimin se janë produkt i vetë bankës. Ndërsa me parashtrimet e depozituara në Kolegj, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur 3 (tri) raporte vlerësimi të pasurive të paluajtshme, një kontratë hipotekimi për marrje kredie, si dhe raport rivlerësimi apartamenti. Ashtu si arsyetuar në paragrafin 13 të këtij vendimi, këto akte shkresore nuk u administruan në cilësinë e provës pasi nuk kënaqnin kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012. Megjithatë, trupi gjykues vëren se, në ankim, subjekti i rivlerësimit për të përforcuar vlerën provuese të vendimeve gjyqësore për pjesëtim pasurie bashkëshortore pas zgjidhjes së martesës, ka pretenduar se aktet e ekspertimit për marrjen e kredive përfshihen në ato prova, që paraqiten si rregull kur njëra palë mund të ketë interes mbi manipulimin e çmimit real të apartamentit të banimit. Nga ana tjetër, në parashtrimet në Kolegj, subjekti i konsideron këto prova të plota, të paatakueshme, duke pretenduar se apartamenti i shitur prej tij ndodhet në kushte më të favorshme, sa i përket vendndodhjes dhe cilësisë me ato objekt vlerësimi. Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit në këto parashtrime është shprehur se mjafton vetëm raporti i rivlerësimit të një apartamenti afër pallatit ku ndodhet dhe apartamenti i tij, vlerësuar 700 euro/m² në datën 20.10.2011, për të provuar që çmimi i shitjes së apartamentit të tij është real, trupi gjykues vëren se nga ana tjetër, vetë subjekti i rivlerësimit ka depozituar gjatë hetimit administrativ në Komision, me përgjigjet e datës 03.09.2020, kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.04.2014, me shitës shoqërinë “{***}” ShPK, blerës z. K.F., me objekt apartamentin me sipërfaqe 112,5 m², lagjja “{***}” Gjirokastër, në vlerën 3.460.000 lekë, pra rreth 4 vite më vonë, duke e bërë të pabesueshëm çmimin e shitjes prej 60.000 eurosh të apartamentit me sipërfaqe 88,8 m², në vitin 2010, nga subjekti i rivlerësimit.

15.14. Gjithashtu, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti kontrata të ngjashme që provojnë pretendimin e tij mbi çmimin real të aplikuar në shitjen e apartamentit 88,8 m², referenca në të dhënat zyrtare të Entit Kombëtar të Banesave nga Komisioni, me qëllim krahasimor në funksion të hetimit të çmimit në këtë rast, që shkon në përputhje edhe me jurisprudencën e tij, u vlerësua e drejtë nga trupi gjykues. Sipas udhëzimit nr. 3, datë 03.02.2010, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2010”, çmimi mesatar i tregut të lirë për vitin 2010, në qytetin e Gjirokastrës, është 48.035 lekë/m², dhe apartamenti me sipërfaqe 88,8 m² i subjektit, do të rezultonte me një vlerë tregu prej 4.265.508 lekësh, ndërkohë që me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.08.2010, është shitur në vlerën 60.000 euro (konvertuar në 8.170.200 lekë). Jurisprudenca¹⁴ e Kolegjit, e sjellë në

¹⁴ Shih vendimin (JR) nr. 34, datë 02.12.2019, paragrafi 67.1, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Prifti.

vëmendje nga subjekti i rivlerësimit, sipas së cilës vlerat e kostos së ndërtimit të zbatuara nga EKB-ja janë në nivele edhe më të ulëta se vlerat mesatare të përcaktuara për tregun e lirë të banesave, nuk mbështet në këtë rast pretendimin e subjektit të rivlerësimit, pasi ka qenë arsyetim për një situatë të ndryshme faktike nga ajo objekt shqyrtimi, ku vlera e blerjes së apartamentit të banimit ishte më e ulët se ajo sipas të dhënave të EKB-së.

15.15. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni në vendim mban një standard ndryshe për shitjen e truallit prej 500 m², ku pranon faktin që nga viti 1998 deri në vitin 2006, vlera e tij është rritur me rreth 600%, dhe për apartamentin e pozicionuar në qendër të qytetit, nuk pranon se mund të shitet në vlerën e tij reale të tregut (pak më shumë se dyfishi i vlerës së shitjes të përlllogaritur në bazë të çmimeve të publikuara nga EKB-ja), trupi gjykues konstaton se, pavarësisht se për vlerën e tregut të apartamentit, Komisioni u referohet të dhënave të tregut të lirë sipas EKB-së, ndërsa për çmimin e truallit i referohet vlerës së tregut, por pa referuar akt ligjor/nënligjor, në vlerësim të këtij pretendimi, duhet mbajtur parasysh fakti se lloji i pasurisë “truall” ndryshon nga pasuria “apartament”, dhe karakteristikat e secilit lloj, tendenca e tregut, sipërfaqet e trojeve në dispozicion në një qytet të caktuar, potenciali i ndërtimit në atë zonë etj. Po kështu, trupi gjykues konstaton se periudha nga blerja dhe shitja e truallit është dy herë më e gjatë se ajo që u përket transaksioneve të kryera me apartamentin. Konteksti kohor ka qenë gjithashtu i ndryshëm, pasi ndryshimet që kanë pësuar tregjet nga viti 1998, janë më të ndjeshme krahasuar me ato që ndodhën në harkun kohor 2006 – 2010, kur ekonomia ka qenë më e stabilizuar dhe për shkak të situatave politike. Për sa arsyetuar më sipër, bëjnë të pabazuar pretendimin e subjektit për mbajtjen e një standardi ndryshe nga Komisioni.

15.16. Pavarësisht se elementet, të drejtat dhe detyrimet e kontratës së shitjes në tregun e lirë imponohen nga vullneti i palëve kontraktore në përcaktimin e tyre, ky vullnet nuk është i pakufizuar, si në përcaktimin e çmimit dysHEME, i cili, për shkak të politikave fiskale, parashikohet në akte nënligjore, po ashtu edhe sa i përket vendosjes së çmimeve që dukshëm tejkalojnë çmimin real të përcaktuar po në akte nënligjore, siç janë dhe ato të parashikuara në udhëzimet dhe vendimet e Këshillit të Ministrave për miratimin e vlerës mesatare të shitjes së banesave në tregun e lirë. Në ankim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vlerës së shitjes së apartamentit, sipas të dhënave të EKB-së, prej 4.265.508 lekësh, duhet t'i shtohet dhe vlera 2.065.729 lekë, e cila përfaqëson koston shtesë të punimeve cilësore, si dhe vlerën e plotë të mobilimit. Në këto kushte, sipas subjektit të rivlerësimit, diferenca që do të mbetej, prej 1.838.963 lekësh, përfaqëson pozicionimin e apartamentit afër qendrës së qytetit, dhe faktin se është një ndërtim i ri. Kjo diferencë prej 1.838.963 lekësh, sipas subjektit, referuar standardit të aplikuar nga Komisioni në jurisprudencën¹⁵ e tij, nuk do të çonte Komisionin në atë konkluzion. Nga analizimi i këtij pretendimi, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit i referohet shumës 2.065.729 lekë (kosto shtesë për punime cilësore dhe mobilim tërësor) edhe në momentin e blerjes së këtij apartamenti në vitin 2006, shumë të cilën subjekti i rivlerësimit e pretendon të përfshirë në çmimin e blerjes prej 3.700.000 lekësh, ndërkohë që siç është përcaktuar në paragrafin 15.9 të këtij vendimi, ky çmim, krahasuar me atë sipas të dhënave të EKB-së në vitin 2006, diferencon vetëm me 234.000 lekë, pa konsideruar mobilim. Përveçse

¹⁵ Shih vendimin nr. 302, datë 02.10.2020 dhe vendimin nr. 308, datë 14.10.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

subjekti i rivlerësimit nuk përcakton vlerën e punimeve cilësore dhe atë të mobilimit tërësor, përkatësisht, që të dyja, sipas tij, përbëjnë 2.065.729 lekë, trupi gjykues vlerëson se mobilimi, për vetë natyrën e investimit, është i amortizueshëm në kohë, e gradualisht humb vlerën e tij reale, pas përdorimit në vite, e për këto arsye nuk është e besueshme se mund të afektojë në një masë kaq të ndjeshme, sa të dyfishojë çmimin e shitjes. Në këto kushte, çmimi 60.000 euro i përcaktuar nga palët kontraktore për apartamentin objekt shqyrtimi, më shumë se dyfishi i çmimit të blerjes së tij para 4 vitesh, dhe pothuajse sa dyfishi i atij të llogaritur sipas të dhënave të EKB-së, në vlerësim të trupit gjykues, nuk justifikohet me pretendimin e vendndodhjes së pasurisë në qendër të qytetit, apo punimeve cilësore dhe mobilimit. Trupi gjykues vlerëson se ky çmim, pavarësisht shlyerjes së detyrimit tatimor mbi të, mbetet joreal.

15.17. Në mbështetje të arsytimit më sipër, trupi gjykues vlerëson se është i drejtë qëndrimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë në deklaratën e pasurisë *vetting*, lidhur me çmimin e shitjes së apartamentit me sipërfaqe 88,8 m² në vitin 2010, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.

16. Për pasurinë apartament me sipërfaqe 126 m², në rrugën “{***}”, subjekti i rivlerësimit, në ankim, ngre këto pretendime: *i. Në vendimin e Komisionit ka mjaftueshëm kontradiktorialitet, lidhur me këtë pasuri, sa rrëzohen konkluzionet e tij të ngritura në formë abstrakte. ii. Analiza e çmimit të shitjes, bazuar në vlerat e publikuara nga EKB-ja, nuk ka asnjë rëndësi, kur në realitet apartamenti nuk është shitur ende as nga i ndjeri B. N apo familjarët e tij dhe as nga shoqëria ndërtuese “{***}” ShPK. Çmimi i apartamentit nuk do të jetë në vlerën sipas EKB-së, por shumë herë më i lartë. iii. Komisioni është i paqartë në lidhje me vlerën e kaparit që subjekti i rivlerësimit duhet t’i jepte ish-pronarit të truallit, me premtimin për shitjen e një apartamenti që do të përfitohej pas ndërtimit të një pallati në truallin e tij, nëse duhet të jepte më shumë hua se 28.000 euro, dhe nëse ka çmime reference për dhënie kapari. iv. Nuk mund të nënshkruhej një kontratë shitblerjeje në kushtet e një shtate të paqartë juridike, siç është ajo e konfliktit gjyqësor, mes z. B. N dhe shoqërisë ndërtuese dhe, për pasojë, bllokimit të transaksioneve për këtë pasuri. Në përfundim të procesit gjyqësor, subjekti i rivlerësimit rrezikon të mos nënshkruajë një kontratë shitblerjeje me pronarin e këtij apartamenti banimi, cilido qoftë, e në rastin më të mirë, mund të marrë mbrapsht shumën e dhënë “hua”, prej 28.000 eurosh. v. Konkluzioni i Komisionit për fshehjen e vlerës reale të blerjes së apartamentit, mbështetet vetëm në aludime. Subjekti i rivlerësimit është i paqartë për përfitimin që ai mund të ketë, në përfundim të “skemës” së fshehjes së pasurisë së paligjshme, si arsyetuar nga Komisioni. Është i pakuptueshëm fakti i përfitimit të apartamentit për të cilin ka paguar minimalisht një vlerë prej 16.698.120 lekësh, pa pasur një dokument pronësie, dhe të vazhdojë të jetojë me “vetëbesimin” që si familjarët “N.”, ashtu edhe shoqëria ndërtuese, pasi të kenë zgjidhur konfliktin gjyqësor, do të lejojnë subjektin të banojë aty, pa tentuar ta shesin për përfitimin e tyre. vi. Përtej tendencës në keqinterpretim, nuk është e qartë se si e konsideron Komisioni mosnënshkrimin ende nga subjekti i rivlerësimit të një kontrate shitblerjeje për apartamentin, për shkak se nuk është përcaktuar pronari i tij, si një “fshehje të pasurisë së paligjshme” apo si një “pamundësi objektive”. Në kushtet e paqartësisë juridike, askush nuk do të nënshkruante një kontratë shitblerjeje apo të deklaronte si pasuri një apartament për të cilin nuk ka siguri edhe për sa kohë do të vijojë të qëndrojë në të. vii. Konkluzionet e Komisionit, bazë e shkarkimit nga detyra, nuk janë të bazuara në asnjë provë dhe shkojnë*

përtej rrjedhës normale të logjikës, pasi lidhja e një kontrate shitblerjeje për një pasuri të paluajtshme me një person që nuk gëzon statusin e pronarit të pasurisë objekt kontrate, prodhon efektin juridik të pavlefshmërisë absolute. Nga analizimi i shkaqeve të ankimit dhe akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues konstaton:

16.1. Komisioni, për këtë pasuri, ka vlerësuar se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, janë të paplota e të pamjaftueshme. Ai nuk deklaroi vlerën reale të kësaj pasurie dhe detyrimin ndaj z. B. N apo detyrimin e mbetur për apartamentin e zotëruar prej tij, duke e fshehur atë. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm në deklaratimet periodike vjetore, duke krijuar kështu vështirësi në kryerjen e veprimeve për verifikimin e kësaj pasurie dhe duke fshehur situatën reale të pasurive të tij dhe të personit të lidhur me të. Nga vlerësimi në tërësi i veprimeve dhe mosveprimeve lidhur me këtë pasuri, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të rremë në deklaratën e pasurisë *vetting*, si lidhur me çmimin real të saj, po ashtu edhe lidhur me sipërfaqen e objektit të zotëruar prej tij, duke u klasifikuar në kushtet e germës “ç” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

16.2. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi shtëpi banimi me sipërfaqe 126 m², e ndodhur në një pallat shumëkatësh, në rrugën “{***}”, Tiranë. Shtëpia është blerë nga z. B. N., të cilit subjekti deklaroi se i ka dhënë vetëm shumën 28.000 euro, sipas deklaratave noteriale, ndërsa shuma tjetër do t’i likuidohet me kredi në momentin e hipotekimit të kësaj shtëpie (mungesa e hipotekimit ka sjellë edhe vonesën e marrjes së kredisë për mungesë kolaterali). Subjekti deklaroi se banon në këtë shtëpi që prej datës 18.11.2012. Po në këtë deklaratë, deklarohet prej tij dhe dhënia hua me deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.03.2011, mikut të vjetër familjar B. N, e shumës 38.000 euro, me qëllim përfitimin e një apartamenti. Kjo shumë është siguruar nga shitja e apartamentit në Gjirokastrë. Nga shuma 38.000 euro, me deklaratën noteriale nr. {***} rep., datë 09.12.2011, i ka marrë z. B. N shumën prej 10.000 eurosh, nga të cilat 4.300 euro janë përdorur për shpenzime të ndryshme familjare dhe 5.700 euro janë depozituar në Bankën Credins.

16.3. Sa u përket deklaratave noteriale lidhur me huan dhe apartamentin, rezultoi se në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.03.2011, B. N dhe Shkëlqim Mustafa deklarojnë se B. N ka marrë hua nga Shkëlqim Mustafa shumën 38.000 euro, dorëzuar në tetor 2010, shumë që do të kthehet brenda dy viteve. Kthimin e kësaj shume e kanë përcaktuar në dy mënyra: ose *cash*, ose me shitjen e një apartamenti në pallatin që ndërtohet në rrugën “{***}” nga shoqëria “{***}” ShPK në truallin e B. N.. Për sa i përket pjesës tjetër që duhet të paguajë Shkëlqim Mustafa për blerjen e apartamentit, ndërmjet tyre do të arrihet një marrëveshje pasi të ketë përfunduar apartamenti.

16.4. Të njëjtët deklarues, më datë 09.12.2011, me deklaratën noteriale nr. {***} rep., deklarojnë se nga shuma 38.000 euro, dhënë me deklaratën e datës 29.03.2011, për blerjen e apartamenti, është kthyer më datë 09.12.2011, shuma 10.000 euro. Ndërsa me deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.01.2017, paraqitur nga subjekti i rivlerësimit me deklaratën e pasurisë *vetting*, z. B. N dhe znj. E. N. deklarojnë se në objektin e ndërtuar nga shoqëria “{***}” ShPK në pronë të tyre, nga përfitimi i apartamenteve, si pronarë truall, për arsye familjare i kanë marrë z. Shkëlqim Mustafa shumën 38.000 euro, për kthim me shitje

apartamenti të përfutur si pronarë truall ose likuidim me këste. Duke qenë se Shkëlqim Mustafa gjatë kohës së shkollimit ka qëndruar në shtëpinë e deklaruesve si mik i hershëm, për likuidim i kanë shitur apartamentin e banimit në rrugën “{***}”, Tiranë, me sipërfaqe 126 m². Në këtë deklaratë, deklaruesit shprehen se kanë rënë dakord që në momentin e hipotekimit të apartamentit, i cili nuk është i hipotekuar nga ana e shoqërisë, shumën e mbetur për shitblerjen e apartamentit t’ua likuidoje me marrjen e një kredie nga banka.

16.5. Lidhur me origjinën e kësaj pasurie, nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues konstaton se më datë 19.09.2006, nënshkruhet kontrata e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., mes pronarëve të truallit prej 417,8 m² dhe apartamentit me sipërfaqe 57 m² që ndodhet në rrugën “{***}”, nr. {***}, Tiranë, B. dhe E. N. dhe sipërmarrësit të shoqërisë “{***}” ShPK, për ndërtimin e një godine banimi sipas lejes që do të jepnin organet kompetente, në të cilën pronarët e truallit do të përfitonin 40% të sipërfaqes së ndërtimit, dhe shtesave nëse do të kishte. Këshilli i Rregullimit të Territorit, Bashkia Tiranë, me vendim nr. {***}, datë 12.10.2008, miraton në favor të subjektit ndërtues “{***}” ShPK, lejen për ndërtimin “Godinë banimi dhe shërbime 6, 8 dhe 9 kate me dy kate parkim nëntokë”, në rrugën “{***}”, me një afat 34 muaj, në pronë të disa familjeve, përfshirë dhe familjen N..

16.6. Më datë 28.08.2010, mes B. dhe E. N. dhe sipërmarrësit, shoqërisë “{***}” ShPK, nënshkruhet kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., “Për përcaktimin e pjesëve që përfiton nga ndërtimi”, nëpërmjet së cilës familja N., në bazë të përlllogaritjeve, do të merrte 1232,21 m² sipërfaqe totale. Në apartamentet e banimit që do të merreshin nga pronarët e truallit, rezulton dhe apartamenti objekt shqyrtimi, me sipërfaqe 122,66 m², i ndodhur në katin e katërt, që nga komunikimi¹⁶ me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë-Veri, rezulton ende në pronësi të shoqërisë “{***}” ShPK.

16.7. Për të qartësuar raportin juridik të subjektit të rivlerësimit me këtë pasuri, Komisioni, në kuadër të hetimit administrativ, i është drejtuar shoqërisë “{***}” ShPK, për informacion lidhur me kontratën që kjo shoqëri ka nënshkruar me z. Shkëlqim Mustafa për ambient banimi, parkim apo njësi tregtare, në objektin “pallat i regjistruar në zonën kadastrale nr. {***}”, me adresë rr. “{***}”, Tiranë. Kësaj kërkesë, shoqëria “{***}” ShPK, me administrator z. G. R., i përgjigjet më datë 13.10.2020¹⁷, duke informuar se z. Shkëlqim Mustafa njihet nga administratori i shoqërisë si posedues apo banues në apartamentin me sipërfaqe 108,24 m², por nuk ka lidhur drejtpërdrejtë asnjë kontratë shitje apo prenotimi me këtë individ për asnjë ambient që ndodhet në objektin në rrugën “{***}”. Apartamenti ku banon Shkëlqim Mustafa pretendohet nga pronarët B. dhe E. N. në kundërshtim me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.09.2010 nënshkruar me shoqërinë “{***}” ShPK. Kjo shoqëri informon se është në konflikt gjyqësor me pronarin B. N. Shoqëria “{***}” ShPK, në përgjigjen e saj, paraqet dhe vendimin nr. {***}, datë 08.04.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin është deklaruar fajtor i pandehuri B. M. për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve” parashikuar nga nenit 186/2 i Kodit Penal, për përpilimin e dokumentit në përcaktimin e sipërfaqes mbi të cilin z. B. N kishte përfutur privatizimin e truallit dhe ndërtesës nga

¹⁶ Me shkresën nr. {***} prot., datë 14.09.2020, të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë-Veri.

¹⁷ Regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 13.10.2020.

Ndërmarrja Komunale Banesa Tiranë (vendim i formës së prerë).

16.8. Sa i përket sipërfaqes së apartamentit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer deklaram të rremë në deklaratën e pasurisë *vetting*, sipas parashikimit në nenin 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion bazohet në faktin se sipërfaqja 126 m² e deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* përputhet dhe atë të përcaktuar në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.01.2017, të B. dhe E. N.. Pavarësisht se nga shoqëria pretendohet me sipërfaqe 108,24 m², nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ saktësohet 122,6 m² dhe në planimetrinë e vënë në dispozicion prej tij, sipërfaqja rezulton 122,64 m² (108,04 m² sipërfaqe ndërtimi dhe 14,6 m² sipërfaqe e përbashkët). Mospërputhjet në sipërfaqe, në vlerësim të trupit gjykues, vijnë edhe si rezultat i disa faktorëve, konkretisht: (i) në regjistrat e pasurive të paluajtshme, regjistrohet vetëm sipërfaqja *neto* e ndërtimit pa sipërfaqet e përbashkëta; (ii) ekzistenca e mospërputhjeve mes sipërfaqeve të ndërtimit në kontratën e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.08.2010 dhe me sipërfaqet në aktin e kolaudimit, mbi bazën e të cilit është bërë regjistrimi i pallatit në emër të shoqërisë ndërtimore, konfirmuar dhe nga Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë¹⁸. Trupi gjykues, gjithashtu, konstaton se Komisioni në paragrafin 4.3 të vendimit, duke iu referuar shkresës nr. {***} prot., datë 14.09.2020, gabimisht i referohet një apartamenti me sipërfaqe 109,83 m², shkalla 2, kati i II, ndërkohë që sipas kësaj shkrese apartamenti i pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, përmban nr. {***}, shkalla 1 me sipërfaqe 122,6 m², kati i IV.

16.9. Mosnënshkrimi ende i kontratës së shitblerjes, sipas subjektit të rivlerësimit, vjen si pasojë e bllokimit të pasurisë për shkak të konfliktit gjyqësor mes pronarëve të truallit dhe shoqërisë “{***}” ShPK. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se pas ndërtimit të pallatit dhe pamundësisë së B. dhe E. N., për të regjistruar pasuritë e parashikuara në kontratën e sipërmarrjes nënshkruar me shoqërinë, ata paraqitën kërkesëpadi në gjykatë, me objekt, ndër të tjera, edhe detyrimin e të paditurit shoqërisë “{***}” ShPK, për zbatimin e kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.02.2010, si dhe sigurim padie e pezullim të të gjitha veprimeve e transaksioneve në ZVRPP-në Tiranë. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se konflikti i pronarëve dhe shoqërisë ka agravuar me proceset e tjera që kanë vijuar mes tyre të karakterit civil, administrativ dhe penal dhe në mbështetje të pretendimeve ka depozituar në Komision aktet gjyqësore, si vijon:

16.9.1. Vendim nr. {***} akti, datë 01.04.2014, më të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pranuar kërkesën për sigurimin e padisë, duke vendosur bllokimin e çdo veprimi ligjor për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme “Pallat”, në rr. “{***}”, Tiranë, i regjistruar në emër të shoqërisë “{***}” ShPK, deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendim nr. {***}, datë 03.04.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***} akti, datë 01.04.2014, me ndryshimin që sigurimi i padisë duhet t’i shtrijë efektet jo mbi të gjithë pallatin e regjistruar në emër të shoqërisë “{***}” ShPK, por vetëm për aq sa palët kanë

¹⁸ Referuar shkresës së datës 13.09.2015, të ZVRPP-së Tiranë drejtuar znj. E. N., parashtrohen arsyet pse nuk janë pajisur me dokument pronësie, ku, ndër të tjera, për apartamentin objekt shqyrtimi shprehet: *ambient banimi nr. {***}, në shkallën I, kati IV me sipërfaqe totale 122,66 m² (sipas kontratës së sipërmarrjes), ndërkohë që sipas aktkolaudimit apartamenti nr. {***}, në po këtë kat, me sipërfaqe 59,21 m², figuron në emër të blerësit M. R..*

rënë dakord në kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.08.2010, objekt konflikti.

16.9.2. Vendim nr. {***} akti, datë 20.12.2016, me të cilin Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesës penale me kërkues B. N dhe F. F., kundër Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt: shfuqizimin e vendimit, datë 10.02.2016, “Për pushimin e çështjes penale nr. {***}”, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe vazhdimin e hetimeve për veprën penale të “Mashtrimit me pasoja të rënda”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal. Lënë në fuqi, me vendimin nr. {***}, datë 07.02.2018, nga Gjykata e Apelit Tiranë.

16.9.3. Vendim nr. {***}, datë 30.07.2018, i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për pranimin e kërkesës së paraqitur nga pala kërkuese B. N dhe E. N. për pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. {***}, datë 06.07.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. {***}, datë 04.04.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë, i cili ka vendosur: “*Ndryshimin e vendimit nr. {***}, datë 06.07.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pranimin pjesërisht të kërkesë padisë të ngritur nga shoqëria “{***}” ShPK. Njohjen e pavërtetësisë së dokumentit certifikatë pronësie, datë 07.01.2014, për pasurinë {***}, nga truall 494 m² në 371 m², ndodhur në Zonën Kadastrale {***} vol. {***}, fq. {***}, rr. “{***}”, Tiranë. Fshirjen e sipërfaqes truall prej 123 m² nga regjistri hipotekor të familjes ‘N.’ (sipërfaqe e dalë 494 m² - 371 m² = 123 m²). Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të saj [...]*”¹⁹.

16.10. Gjatë hetimit administrativ në Komision, kërkesës së Komisionit për të shpjeguar se si ka mundësi që jeton që prej vitit 2012 në një banesë e cila ndodhet në një zonë atraktive në Tiranë, për të cilën ka paguar një vlerë minimale fillestare prej 28.000 eurosh, subjekti i rivlerësimit i përgjigjet se nuk jeton në banesë pa një marrëveshje konkrete juridike dhe pa paguar asnjë shumë të kontratës, si dhe sqaron se diferenca e çmimit do të paguhet kur të përmbushet kushti kontraktor i regjistrimit të pasurisë nga familja N. dhe nënshkrimi i kontratës të shitjes me subjektin, vonesa e të cilës është e ndërvarur nga shkaqe të pamundura prej tij. Apartamenti, sipas subjektit, nuk ka kaluar formalisht në pronësinë e z. B. N., marrëdhënia e ngushtë familjare me të cilin ka lejuar ta konsiderojnë marrëdhënien me njëri-tjetrin një marrëdhënie të posaçme, alternativë e njohur dhe e lejuar nga ligji civil.

16.11. Subjekti i rivlerësimit, si në Komision, ashtu edhe me parashtrimet në Kolegj, sqaron se me B. dhe E. N. kanë pasur njohje dhe miqësi shumë të ngushtë familjare. Me vullnet të lirë dhe të plotë mes tyre u vendos për të kryer një marrëveshje të karakterit kontraktual, për blerjen e një prej pasurive që B. N. do të përfitonte si rezultat i shkëmbimit të truallit të dhënë për ndërtim, me apartamentet që duhej të përfitoheshin sipas dakordësisë së të dy palëve. Fillimisht, sipas sqarimit të subjektit, u ra dakord që për këtë apartament shuma e parë do të ishte 38.000 euro, që do të përkonte me pagimin e një kësti paraprak. Për këtë u redaktua dhe akti noterial nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 29.03.2011, sipas së cilit pjesa tjetër e detyrimit do të përcaktohej në momentin kur z. N. do të finalizonte marrëveshjet e shkëmbimit me

¹⁹ Në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, rezulton se me vendimin nr. {***}, datë 02.02.2023, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, ka vendosur: “1. Mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala e paditur, [...], trashëgimtarët e B. N. kundër vendimit nr. {***}, datë 04.04.218, të Gjykatës Administrative të Apelit; 2. Revokimin e masës së pezullimit të ekzekutimit të vendimit nr. {***}, datë 06.07.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. {***}, datë 04.04.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, të dhënë me vendimin nr. {***}, datë 30.07.2018, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë”.

shoqërinë ndërtuese, pasuria do të regjistrohej në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si kusht thelbësor për vlefshmërinë e një kontrate shitje, referuar Kodit Civil, përkatësisht në nenet 83 dhe 750. Deklarata noteriale, sipas subjektit të rivlerësimit, në thelb është një kontratë shitje me rezervë dhe për faktin se nga deklaruesit ka qenë konsideruar e tillë, ka mjaftuar për vlefshmërinë e saj përkundrejt tyre dhe përputhet plotësisht edhe me nenin 746 të Kodit Civil.

Diferenca, sipas subjektit, do të paguhet kur kushti kontraktor të vërtetohet e prej këtij çasti varet përmbushja apo plotësimi i marrëdhënies kontraktore. Sipas marrëveshjes dhe vetë natyrës së marrëdhënies juridike, sqaron subjekti, vlera e mbetur e detyrimit do të përcaktohej në një marrëveshje të dytë, pas regjistrimit të sendit dhe sigurimit të një kredie bankare duke lënë kolateral apartamentin si kusht thelbësor për disbursimin e kredisë, në kushtet kur nuk dispononte pasuri tjetër të paluajtshme. Në kushtet e konfliktit gjyqësor, marrëveshja e realizuar në vitin 2011 vijon të ketë vlefshmëri juridike, për sa kohë nuk është realizuar ende kushti thelbësor i regjistrimit të pasurisë. Subjekti i rivlerësimit sqaron se ka qenë e pamundur realizimi i kontratës përfundimtare të shitjes dhe pagimi i pjesës së mbetur të detyrimit, për sa kohë që konfliktet ligjore nuk kanë përfunduar ende dhe pasuria objekt shqyrtimi është e paregjistruar.

16.12. Subjekti i rivlerësimit, në vijim ka shpjeguar, gjithashtu, se aktet noteriale gjenden të deklaruara në deklaratat e interesave privatë periodikë të vitit 2010 dhe 2011. Çdo veprim juridik për blerjen e apartamentit është deklaruar qartësisht e pa asnjë hezitim. Subjekti i rivlerësimit pretendon të ketë qenë transparent, pa pasur asnjë tendencë për të mos deklaruar finalizimin e përfitimit të këtij apartamenti, pavarësisht kohës kur ai mund të regjistrohet dhe atij t'i jepet mundësia të kryejë veprimet e tjera noteriale e financiare. Subjekti parashtron, gjithashtu, se nuk ka pasur asnjë tendencë për të fshehur realitetin e një veprimi juridik dhe se gjendja aktuale e akteve noteriale nuk krijon asnjë mundësi që në të ardhmen të shmangë nga kontrolli i organeve shtetërore finalizimin e blerjes së këtij apartamenti, ILDKPKI-së nëse do të vazhdojë të jetë subjekt deklarimi dhe në të kundërt Drejtorisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave e ngarkuar për të kontrolluar ligjshmërinë e burimit financiar të pasqyruar në akte noteriale.

16.13. Nga analizimi i deklaratës noteriale të datës 29.03.2011, në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjyqësor konstaton mospërputhje sa i përket pagesës së pjesës tjetër për blerjen e apartamentit, pasi në deklaratën noteriale 2011 B. N. dhe Shkëlqim Mustafa kanë përcaktuar se kjo *do të arrihet në një marrëveshje mbasi të ketë përfunduar apartamenti*, gjë që nënkupton se përfundimi i apartamentit nuk lidhet me regjistrimin e pasurisë, por me përfundimin e ndërtimit dhe subjekti i rivlerësimit deklaroi se banon në të që prej datës 18.11.2012 e, në këto kushte, duhet të kishte përcaktuar çmimin e apartamentit dhe pagesën e pjesës së mbetur, si dhe ta deklaronte në deklaratën e interesave privatë të këtij viti, gjë që nuk e ka bërë. Kushti i regjistrimit të apartamentit, për marrjen më pas të kredisë nga banka për blerjen e tij, është pretenduar gjatë procesit të rivlerësimit, konkretisht në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.01.2017, të B. dhe E. N., depozituar nga subjekti i rivlerësimit me deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe në pretendimet e tij gjatë hetimit administrativ.

16.14. Trupi gjykues gjen të pambështetura në ligj pretendimet e subjektit të rivlerësimit se deklarata noteriale e datës 29.03.2011, me të cilën është dhënë hua shuma 38.000 euro, është një kontratë shitje me rezervë dhe përputhet me nenin 746 të Kodit Civil²⁰. Në kuptim të kësaj dispozite, “rezerva” konsiston në faktin e pagesës me këste të çmimit të sendit të paluajtshëm, i cili *apriori* duhet të jetë përcaktuar në kontratë. Me fjalë të tjera, nuk mund të ketë një kontratë shitje me rezervë pa përcaktuar çmimin e plotë dhe mënyrën e pagesës së tij. Trupi gjykues sjell në vëmendje se në kohën kur është nënshkruar deklarata noteriale e datës 29.03.2011, me të cilën është dhënë huaja 38.000 euro, që ka parashikuar si mënyrë kthimi edhe *shitjen e një apartamenti në rrugën “{***}” nga shoqëria “{***}” ShPK, në truallin e B. N.*, mes këtij individit dhe shoqërisë ndërtimore ishin nënshkruar kontrata e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.09.2006 dhe kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.08.2010, për përcaktimin e pjesëve të ndërtimit që i takonin pronarit të truallit, përfshirë edhe apartamentin nr. {***}, me sipërfaqe 122,66 m², kati i katërt. Në momentin që subjekti i rivlerësimit ka hyrë për të banuar në këtë apartament, më 18.11.2012, mes pronarit të truallit B. N. dhe shoqërisë “{***}” ShPK nuk kishin nisur ende mosmarrëveshjet apo konfliktet gjyqësore, të cilat rezultojnë të kenë ndodhur më vonë, në vitin 2014. Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se dispozitat ligjore nuk pengonin pronarin e truallit që pasuritë e përfituara nga kontrata e sipërmarrjes, edhe pse ende të paregjistruara në emër të tij, t’i dispononte nëpërmjet kontratës së shitjes me kusht apo kontratës premtim shitje. Nënshkrimi i një kontrate të tillë duhet të ishte kërkuar nga subjekti i rivlerësimit, pasi në kushtet e një kontrate që do të përmbante detyrimisht çmimin e shitjes, si kusht thelbësor i ekzistencës së saj, do t’i siguronte subjektit të rivlerësimit më tepër garanci lidhur me përfitimin e kësaj pasurie në të ardhmen, me një çmim të parashikueshëm e të pandryshueshëm.

16.15. Trupi gjykues, konstaton se Komisioni shumë 28.000 euro, të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si këst paraprak, e ka konsideruar shumë më të ulët, krahasuar me vlerën e tregut, sipas të dhënave të EKB-së për vitet 2010 dhe 2013²¹, në vlerën 15.938.000 lekë dhe 16.698.120 lekë, përkatësisht. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar referimin te të dhënat e EKB-së, pasi sipas tij vlera do të jetë më e madhe, por ndërkohë me prapësimet mbi rezultatet e hetimit administrativ ka vënë në dispozicion kontrata porosie/paraprake shitje²² të nënshkruara nga shoqëria “{***}” ShPK me individë të tjerë, për apartamentet në të njëjtën godinë me të, në të cilat çmimi rezulton edhe më i lartë se ai i EKB-së dhe kësti i parë i parashikuar në to më i lartë se shuma 28.000 euro paguar nga subjekti i rivlerësimit. Nga ana tjetër, trupi gjykues konstaton se për subjektin e rivlerësimit nuk është e qartë se çfarë përfaqëson në vetvete shuma 28.000 euro, pasi njëherë i referohet si kapar, që në vetvete përbën një garanci dhe njëherë si këst paraprak, pra, pagesë çmimi. Trupi gjykues çmon se shuma e paguar nga subjekti i rivlerësimit nuk e bën të besueshëm posedimin për një periudhë relativisht

²⁰ Neni 746 i Kodit i Civil të Republikës së Shqipërisë, parashikon: “Kur çmimi i shitjes paguhet me këste, blerësi e fiton pronësinë e sendit me pagimin e këstit të fundit të çmimit, duke marrë përsipër rreziqet që në çastin e dorëzimit. Kalimi me rezervë i pronësisë me kushtin e sipërm duhet të pasqyrohet në kontratë”.

²¹ Shih: Udhëzimin nr. 3, datë 03.02.2010, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2010” dhe Udhëzimin nr. 1, datë 08.05.2013, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, për vitin 2013”.

²² Përcjellë subjektit të rivlerësimit nga AShK, Drejtoria Vendore Tirana-Veri, me shkresën nr. {***} prot., datë 06.11.2020.

të gjatë të një apartamenti me sipërfaqe 122,66 m², të ndodhur në qendër të kryeqytetit, e me një vlerë tregu të konsiderueshme, përkundrajt pagesës vetëm të një shume prej 28.000 eurosh.

16.16. Në përfundim të sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues vlerëson se pretendimet e subjektit të rivlerësimit se nëpërmjet deklaratës së datës 29.03.2011 ka konkluduar një kontratë shitje me rezervë, për apartamentin në analizë pa përcaktuar çmimin e tij, janë jo bindëse dhe të pambështetura në konceptet dhe institutet e së drejtës civile për fitimin e pronësisë me anë të veprimit juridik të shitjes me rezervë, por edhe në një logjikë të pranueshme ekonomike dhe, aq më tepër, në situatën e një pale që ka detyrimin për të deklaruar rreth pasurisë së tij në mënyrë periodike. Në këto kushte, trupi gjykues gjen me vend aplikimin e nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaramin të rremë lidhur me çmimin e shitjes së kësaj pasurie.

17. Për pasurinë, automjet “Mercedes-Benz”, tip “ML 350 CDI 4MATIC”, subjekti i rivlerësimit ka ngritur këto pretendime në ankim: *i. Pretendimi i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion provues se cili është pronar i automjetit është absurd, pasi edhe pse z. I. M. është zhvendosur në Mbretërinë e Bashkuar, pronësia nuk humbet, pavarësisht ndodhjes së pronarit jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Në këto kushte, I. M. vazhdon të jetë dhe aktualisht pronar i këtij automjeti; ii. Mbi aftësinë paguese të z. I. M. dhe z. B. M., subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision dokumentacion për të vërtetuar se këta individë kanë pasur mundësi të blejnë jo vetëm këtë automjet, por edhe disa automjete të tjera; iii. Ndryshe nga sa konstaton Komisioni, bazuar në të dhënat e sistemit TIMS evidentohet qartë se I. M. ka kaluar 6 herë kufirin e Republikës së Shqipërisë me këtë automjet; iv. Mosdeklarimi i përdorimit të automjetit në deklaratat periodike vjetore dhe deklaratën e pasurisë vetting vjen pasi detyrimi për deklarimin e përdorimit të sendeve të paluajtshme/luajtshme jo në pronësi hyri në fuqi vetëm pas ndryshimeve të bëra përmes ligjit nr. 42/2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar. Përdorimi i automjetit nuk është deklaruar as në deklaratën e pasurisë, e cila u plotësua përpara hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve ligjore. Për këtë arsye konkluzionet e Komisionit nuk qëndrojnë dhe nuk përputhen me realitetin e kuadrit përkatës rregullator; v. Në lidhje me dyshimet se ky automjet është pasuri e subjektit të rivlerësimit, Komisioni vendos një standard, sipas së cilit çdo subjekt rivlerësimi që është i pajisur me një autorizim për përdorimin e një automjeti në pronësi të familjarëve të tij do të akuzohet automatikisht se ka fshehur këtë pasuri e që në të vërtetë nuk është përdorues, por pronar i saj. Blerja e këtij automjeti në Gjermani është larg standardit ekonomik të subjektit, i cili deklaron se vazhdon ta përdorë dhe mirëmbajë automjetin tip “Benz 2011” të blerë në vitin 2010 e nëse do të donte të blinte një automjet të ri fillimisht do të kishte shitur atë që dispononte; vi. Komisioni nuk ka zbatuar standardet e jurisprudencës së tij, se, -- në vlerësimin e ekzistencës ose jo të fshehjes së pasurisë duhet të merret në konsideratë edhe sjella/qëndrimi i subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit, -- në rast kur subjekti i rivlerësimit ka pasur burime të ligjshme për krijimin e pasurisë objekt pasaktësie, ajo do të konsiderohet pakujdesi në plotësimin e deklaratave dhe jo fshehje/mosdeklarim me pasoja për subjektin e rivlerësimit. Në analizë të këtyre shkaqeve ankimore, trupi gjykues konstaton:*

17.1. Komisioni, në përfundim të vlerësimit lidhur me këtë pasuri, bazuar në faktet dhe provat e rezultuara gjatë hetimit, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e germës “c”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, duke e fshehur këtë pasuri në deklaratën e pasurisë *vetting*.

17.2. Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore sa i përket kësaj pasurie, trupi gjykues konstaton se në përgjigjet e pyetësorit standard, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka përdorur disa herë automjetin “Mercedes-Benz”, me targë {***}, në pronësi të z. I. S. M. (djali i vajzës së xhaxhait). Me përgjigjet, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur edhe dokumentin “Autorizim për përdorim automjeti” nr. {***} rep., datë 17.09.2014, sipas së cilit I. S. M. autorizon subjektin Shkëlqim Mustafa të përdorë automjetin e tij të markës “Mercedes-Benz”, tipi “ML 350 CDI 4MATIC”, vit prodhimi 2011, me targë {***}, për një periudhë kohe të pacaktuar, brenda dhe jashtë vendit.

17.3. Referuar dokumenteve të dosjes së këtij automjeti të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, me shkresën nr. {***} prot., datë 19.08.2020, rezultoi që automjeti “Mercedes-Benz ML 350 CDI”, vit prodhimi 2011, është në pronësi të z. I. S. M., regjistruar më datë 16.09.2014. Automjeti është blerë nga I. M. pranë kompanisë “Mercedes-Benz”, në Gjermani, në vlerën 35.000 euro, më datë 09.09.2014. Në çmimin prej 35.000 eurosh është përfshirë dhe taksa prej 19 %, në vlerën 5.588,24 euro, e cila i është rimbursuar z. I. M. në llogarinë e tij bankare pranë “Raiffeisen Bank” ShA, më datë 26.09.2014. Për këtë automjet janë paguar detyrimet doganore nga I. M., në vlerën 828.600 lekë.

17.4. Nisur nga përgjigjja e subjektit të rivlerësimit dhe nga të dhënat e sistemit *TIMS* të hyrje/daljeve në Republikën e Shqipërisë, sipas së cilave rezultonte që subjekti i rivlerësimit kishte përdorur disa herë automjetin me targë {***}, Komisioni i kërkoi të paraqiste dokumentacion lidhur me blerjen e këtij automjeti, mundësitë financiare të z. I. M. për blerjen e tij, si dhe qëllimin e lënies së tij në përdorim për një periudhë të pacaktuar.

Subjekti i rivlerësimit sqaroi se automjeti figuron i regjistruar në emër të I. M. që është nipi i tij, djali i vajzës së xhaxhait, por është pronë e nipit tjetër, z. B. M., djali i djalit të xhaxhait, i cili jeton familjarisht prej më shumë se 20 vitesh në Angli. Meqenëse nuk lejohej ligjërish të kishte një automjet me targë shqiptare, duke qenë shtetas anglez, e ka regjistruar në emër të I. M.. Automjeti u ble nga B. M., për përdorim personal dhe të babait të tij gjatë kohës së qëndrimit në Shqipëri. Për shkak të lidhjes së ngushtë vëllazërore që subjekti i rivlerësimit kishte me familjen e djalit të xhaxhait, si dhe për të mos lënë automjetin për një kohë të gjatë pa lëvizur, u autorizua për ta përdorur. Sqarimet e subjektit të rivlerësimit përmenden më pas dhe në deklaratën e z. B. M. dhe z. I. M.. Më tej, subjekti i rivlerësimit bën me dije se nuk kishte ndonjë nevojë për të përdorur këtë automjet, pasi dispononte automjetin e tij me targë {***}, që ishte në gjendje të mirë teknike. Për të provuar lidhjen e ngushtë me fëmijët e xhaxhait të tij, subjekti depoziton dokumente²³ të lëshuara nga autoritetet vendore të vendlindjes së subjektit të rivlerësimit, që deklarojnë se në vitin 1987 Shkëlqim Mustafa ka mbetur jetim e, për këtë arsye, ka jetuar me xhaxhain Q. M. dhe familjen e tij deri me përfundimin e shkollës së mesme, në vitin 1989.

17.5. Për të provuar mundësinë financiare të z. B. M., subjekti ka depozituar dokumente mbi: (i) të ardhurat në vitet 2010 – 2013, nga aktiviteti privat i shoqërisë “{***}” përkatësisht: për vitin tatimor 2010 – 2011, në shumën 72.600 GBP; për vitin tatimor 2011 – 2012, në shumën 80.630 GBP; për vitin tatimor 2012 – 2013, në shumën 82.620 GBP, sipas vërtetimit të datës

²³ (i) Vërtetim nr. {***} prot., datë 26.08.2020, i kryetarit të Bashkisë Fushë-Arrëz; (ii) vërtetim nr. {***} prot., datë 26.08.2020, i kryetarit të fshatit Micoj; (iii) deklaratë, datë 26.08.2020, e kryetarit të Këshillit të Fshatit.

29.10.2020 të shoqërisë “{***}”²⁴; (ii) taksat e përlogaritura nga totali i të ardhurave nga vetëpunësimi dhe dividendi për periudhën 2010 -2011, 2013-2014 dhe 2014-2015, të lëshuar nga “HM Revenue & Customs”²⁵; si dhe (iii) lëvizje të llogarive bankare²⁶ të z. B. M. dhe z. I. M.. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se shumat për blerjen e automjetit burojnë nga të ardhurat e ligjshme nga veprimtaria tregtare e z. B. M. dhe i janë dërguar I. pjesërisht me bankë e pjesërisht *cash*. Kur është blerë automjeti në Gjermani, B. nuk ka qenë fizikisht, por pasi e ka përzgjedhur në internet i ka kërkuar I. të shkonte ta blinte. Ky automjet është mbajtur nga I. deri para dy vitesh kur ai është zhvendosur dhe banon në Angli.

17.6. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë bankare të z. B. M. rezulton të jenë transferuar për llogari të z. I. M., në “Raiffeisen Bank” ShA, shuma 5.100 GBP, më datë 11.04.2011, shuma 29.000 GBP, më datë 19.08.2011 dhe shuma 13.000 GBP, më datë 30.08.2011. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarisë bankare në monedhën GBP të z. I. M., pranë “Raiffeisen Bank” ShA, për periudhën 13.04.2011- 04.04.2012, rezulton të jenë transferuar nga B. M. dhe të jenë tërhequr nga I. M. rreth 80.000 GBP.

17.7. Komisioni në vendim arsyeton se duke iu referuar jurisprudencës së Kolegjit, për çdo situatë të dyshuar për pasuri të fshehur të subjektit të rivlerësimit i ka kërkuar atij shpjegime, lidhur me marrëdhënien me z. I. M. duke e konsideruar person tjetër të lidhur, si dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave për blerjen e automjetit, ka arritur në konkluzionin se z. B. M. ka pasur të ardhura *neto* në vlerën 41.630 GBP, në vitin 2014, në periudhën kur është blerë automjeti, por nuk provohet aftësia financiare e B. M. dhe I. M..

17.8. Për sa i përket përdorimit faktik të këtij automjeti, nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, trupi gjykues konstaton se nga blerja e këtij automjeti në shtator 2014 subjekti i rivlerësimit, sipas të dhënave të sistemit *TIMS* deri në fund të vitit 2019, rezulton të ketë kaluar në pikat doganore rreth 15 herë. Sipas të dhënave të këtij sistemi nuk rezulton që automjeti të jetë përdorur nga Xh. dhe B. M., ndërsa I. M. ka kaluar pikat doganore disa herë me këtë automjet²⁷. Trupi gjykues konstaton se Komisioni në vendim ka arsyetuar gabim kur shprehet se automjeti, i cili figuron në emër të I. M., nuk është përdorur prej tij. Me parashtrimet e depozituara në Kolegj, subjekti sqaron se automjeti është përdorur prej tij vetëm për 18 udhëtime jashtë vendit për një periudhë 8-vjeçare, në Greqi, Mal i Zi dhe Maqedoni e Veriut dhe në kushtet kur përdorimi i automjetit jashtë shtetit kërkonte patjetër autorizim apo kontratë huapërdorje, për këtë shkak, është pajisur me autorizim. Në vijim të parashtrimeve, subjekti shprehet se më datë 16.08.2022 B. M. ka kaluar në pikën kufitare Hani i Hotit me këtë automjet, të cilin vazhdon ta përdorë në Angli, ku dhe është gjobitur disa herë.

17.9. Pavarësisht se nga aktet e dosjes rezulton se automjeti është blerë nga I. M. më datë 09.09.2014, është regjistruar në pronësi të tij më datë 16.09.2014 dhe vetëm të nesërmen më datë 17.09.2014 ai ka autorizuar subjektin e rivlerësimit për përdorimin e këtij automjeti, në kushtet kur Komisioni nuk është shprehur përfundimisht për aftësinë financiare të z. B. M. dhe z. I. M., për blerjen e këtij automjeti, nuk mund të konkludonte se është pasuri e fshehur e

²⁴ <https://www.flashforwardlondon.co.uk>. Në këtë vërtetim citohet se B. M. ka qenë klient i kësaj shoqërie 10 vitet e fundit dhe kjo shoqëri i kryen gjithë shërbimet për çështjet e taksave dhe tatimeve, si hartimin e deklaratave tatimore etj.

²⁵ Departamenti i Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar për mbledhjen e taksave.

²⁶ Lloyd TSB Bank për B. M. dhe Raiffeisen Bank ShA për I. M..

²⁷ Nga të dhënat e sistemit *TIMS*, përcjellë nga Komisariati i Policisë Pukë, me shkresën nr. {***} prot., datë 30.10.2020, rezulton se z. I. M., ka përdorur këtë automjet për daljet nga Shqipëria më datat: 30.05.2017 dhe 14.08.2017, si dhe ka hyrë më datat: 16.09.2016, 15.02.2017, 06.06.2017, 21.08.2017 dhe 02.11.2017.

subjektit të rivlerësimit, por përdorimi i tij është fshehur nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*.

17.10. Në lidhje me mosdeklarimin e përdorimit të automjetit, subjekti i rivlerësimit pretendon se gjatë hetimit administrativ ka qenë i sinqertë dhe transparent, duke deklaruar përdorimin e këtij automjeti e, në kushtet që nuk ka qenë pronar i tij, ka vlerësuar të mos e deklarojë në deklaratimet periodike vjetore dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*. Detyrimi për deklarimin e përdorimit të sendeve të paluajtshme/luajtshme jo në pronësi, sipas subjektit të rivlerësimit u parashikua me ndryshimet e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, të ndryshuar, me ligjin nr. 42/2017. Gjithashtu, edhe deklarata e pasurisë *vetting* u plotësua përpara hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve ligjore. Për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzionet e Komisionit nuk qëndrojnë dhe nuk përputhen me kuadrin përkatës rregullator. Mungesa e deklarimit të përdorimit, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk mund të vlerësohet në asnjë rast si fshehje e pasurisë, por pasaktësi apo mungesë kujdesi gjatë plotësimit të deklaratave, që nuk mund të ngrihen në atë nivel sa të përligjin dhënien e një mase disiplinore.

17.11. Trupi gjykues, vlerëson se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar, pasi ndryshimet e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 dhe vetë ky ligj nuk kanë efekt mbi plotësimin e deklaratës së pasurisë *vetting*. Në kuadër të procesit të rivlerësimit, neni D, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës parashikon se *subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin dhe ky deklarim, në kuptim të pikës 1 të këtij neni, duhet të jetë një deklarim saktësisht dhe plotësisht i pasurive në pronësi dhe përdorim. Deklarata e pasurisë *vetting*, sipas shtojcës 2, është miratuar me ligjin nr. 84/2016, parashikuar në nenin 31, pika 1 të tij dhe në të është përcaktuar deklarimi i pasurive në pronësi, në posedim apo në përdorim. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të deklaronte automjetin objekt shqyrtimi, si një pasuri në përdorim. Ndërsa sa i përket qëndrimit të Kolegjit në vendimin nr. 27 (JR), datë 06.07.2022, paragrafët 75, 76 dhe 77, të cilit subjekti i rivlerësimit i drejtohet si një rast tërësisht analog, trupi gjykues konstaton se në këtë çështje subjekti i rivlerësimit rezultonte të kishte deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* përdorimin e automjetit në emër të babait, fakt që nuk ka ndodhur në rastin objekt shqyrtimi.*

17.12. Për shkak të të gjitha rrethanave të përshkruara më sipër, për pasurinë, automjet “Mercedes- Benz”, tip “ML 350 CDI 4MATIC”, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting* ka kryer të paktën fshehje të pasurisë në përdorim, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.

18. Për analizën financiare 2003 – 2016, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se ekzistenca e një bilanci negativ në vlerën (-) 752.488 lekë [përkatësisht (-) 258.103 lekë në vitin 2008 dhe (-) 467.377 lekë në vitin 2014], në përfundim të analizës financiare, nuk përbën shkak për shkarkimin e tij nga detyra si gjyqtar dhe Komisioni duhet të zbatonte të njëjtin standard si në vendimet e jurispruencës së tij.

18.1. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, trupi gjykues i Kolegjit konfirmon pamjaftueshmërinë e burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, në vlerën (-) 797.696 lekë, për periudhën e rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016. Pretendimin e subjektit të rivlerësimit se diferenca

negative e konstatuar nuk ngrihet në atë nivel pamjaftueshmërie sa për të qenë shkak për shkarkimin e tij nga detyra, trupi gjykues e gjen të pazbatueshëm në rastit objekt shqyrtimi, për shkak se në vlerësimin kumulativ të çështjes, mungesa e burimeve financiare të ligjshme dhe konkluzionet e arritura për të tria çështjet e trajtuara në këtë vendim, si deklarimi i rremë në deklaratën e pasurisë *vetting* lidhur me çmimin e shitjes së apartamentit me sipërfaqe 88,8 m², në Gjirokastrë, deklarimi i rremë lidhur me çmimin e apartamentit në Tiranë, si dhe fshehja e përdorimit të automjetit në pronësi të z. I. M., së bashku, konfirmojnë përfundimin se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë për kriterin e vlerësimit të pasurisë.

19. Në këto kushte, trupi gjykues në Kolegj, mbështetur në nenin D, pikat 1 dhe 5 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe çmon se vendimi nr. 333, datë 13.01.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i drejtë dhe, si i tillë, duhet lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 333, datë 13.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Shkëlqim Mustafa.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe me efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 04.04.2023.

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi - kundër

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e relatores së çështjes, në përfundim të shqyrtimit në dhomë këshillimi, kam propozuar: *ndryshimin e vendimit nr. 333, datë 13.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Shkëlqim Mustafa*. Jam kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues, me arsyetimin në vijim.

2. Lidhur me pasurinë “apartament banimi”, me sipërfaqe 88,8 m², ndodhur në qytetin e Gjirokastrës:

2.1. Në cilësinë e gjyqtare në pakicë, kundërshtoj konkluzionin e shumicës së trupit gjykues se *subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të rremë në deklaratën e pasurisë “vetting”, lidhur me çmimin e shitjes së apartamentit me sipërfaqe 88,8 m² në vitin 2010, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016.*

2.2. Nga dokumentacioni i administruar dhe i nënshtuar debatit gjyqësor nga trupi gjykues, ka rezultuar e provuar se:

2.2.1. Subjekti i rivlerësimit Shkëlqim Mustafa, nëpërmjet kontratës së shitjes së pasurisë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.09.2006, ka blerë nga vjehri i tij, E. F., apartamentin e mësipërm në vlerën 3.700.000 lekë. Sipas kësaj kontrate, shuma prej 700.000 lekësh është likuiduar nga subjekti i rivlerësimit ditën e nënshkrimit të kontratës, ndërsa diferenca prej 3.000.000 lekësh do të likuidohej në momentin e lëvrimit të kredisë nga Alpha Bank ShA. Po sipas dokumentacionit, rezulton e provuar se likuidimi i këtij apartamenti nga subjekti i rivlerësimit është kryer ashtu sikundër edhe ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratën e interesave privatë 2006, nga të ardhurat e përfituara në vlerën 700.000 lekë, nga shitja e truallit në pronësi në korrik të vitit 2006, dhe nga kredia e financuar nga Alpha Bank ShA, në vlerën 3.000.000 lekë, në tetor të vitit 2006. Lidhur me vlerat e mësipërme, paguar për likuidimin e apartamentit nga subjekti i rivlerësimit, unë si gjyqtare në pakicë dhe shumica e trupit gjykues nuk kemi konstatuar mangësi apo dyshime në deklarinimet e subjektit të rivlerësimit, ndryshe nga sa konkludon Komisioni në vendimin nr. 333, datë 13.01.2021, për këtë pasuri. Transaksionet e kryera, si: blerja dhe shitja e truallit, blerja e apartamentit, marrja e huas provohen me kontrata noteriale të kohës, me fuqi të plotë provuese, të cilat nuk ka sesi të krijojnë bindjen se këto veprime mund të jenë fiktive.

2.2.2. Referuar dokumentacionit provues të administruar në dosje, përfshirë deklaratën e pasurisë *vetting*, deklarinimet periodike vjetore të subjektit të rivlerësimit pranë ILDKPI-së, përgjigjet e dhëna pyetësorëve gjatë hetimit administrativ në Komision, kërkimet e tij në ankim dhe në parashtrimet e depozituara në Kolegj, është pretenduar i njëjti fakt nga subjekti i rivlerësimit se, me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.08.2010, apartamentin me sipërfaqe 88,8 m², ndodhur në lagjen “{***}”, në qytetin e Gjirokastrës, subjekti ua shet shtetasve E. dhe L. H., në vlerën 60.000 euro, shumë e cila është likuiduar sipas përcaktimeve në kontratë: kësti i parë në vlerën 30.000 euro, u pagua në datën 02.04.2010, dhe kësti i dytë në shumën 30.000 euro, iu likuidua subjektit të rivlerësimit në

ditën e nënshkrimit të kontratës. Në këtë kontratë, citohet se shitësi, me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë, deklaron se këtë pasuri e shet te blerësit me të gjitha pajisjet shtëpiake, për të cilat blerësit nuk kanë pasur asnjë pretendim për gjendjen e tyre fizike.

2.2.3. Gjithashtu, këtë transaksion, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003, në deklaratën e interesave privatë 2010, ku deklaron edhe përdorimin e shumës së përfituar nga shitja e apartamentit në Gjirokastrë – për shlyerjen totale të kredisë së marrë në Alpha Bank ShA, në prill 2010, për blerjen e një automjeti, dhe për një hua, dhënë mikut të tij të vjetër, z. B. N.. Këtë hua do ta trajtoj në vijim, pasi është e lidhur me pasurinë *apartament* të ndodhur në qytetin e Tiranës, ku subjekti i rivlerësimit banon prej muajit nëntor të vitit 2012 deri aktualisht.

2.3. Mbështetur në dokumentacion provues të cituar më sipër, si gjyqtare në pakicë, vlerësoj se nuk provohet me asnjë provë që çmimi 60.000 euro i shitjes së këtij apartamenti me kontratën e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.08.2010, është *çmim joreal*, dhe të jetë kjo arsye që të vendosë subjektin e rivlerësimit në kushtet e kryerjes së një deklarimi të rremë, siç ka konkluduar shumica. Arrij në këtë përfundim, për arsyet e paraqitura më poshtë.

2.4. Janë një sërë faktorësh që e bëjnë çmimin e shitjes së këtij apartamenti të besueshëm dhe mbi të gjitha real. Shumica e trupit gjykues duhet të kishte analizuar me objektivitet faktorët e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, të cilët në mënyrë të padiskutueshme ndikojnë në çmimin e shitjes së apartamentit, e që në asnjë rast diferenca që mund të rezultonte më pas, nuk mund të klasifikohet si paligjshmëri e të penalizonte subjektin e rivlerësimit. Referuar udhëzimit nr. 3, datë 03.02.2010²⁸, pika 4: *Vlerat mesatare të banesave në tregun e lirë nuk mund të përdoren për t’iu referuar zonave të afërta*. Pra, të dhënat nga EKB-ja për qytetin e Gjirokastrës, në vitin 2010, japin vlerën mesatare ose minimale të çmimit të shitjes së apartamenteve në tregun e lirë për këtë qytet. Këto të dhëna nuk reflektojnë diferencimet në çmimet e shitjes së pasurisë së paluajtshme sipas zonave të qytetit. Në rastin në fjalë, vendndodhja e apartamentit pranë qendrës së qytetit, pranë zonës muzeale dhe institucioneve arsimore, shëndetësore e kulturore, arsyeshem ndikon në vlerën e shtuar të shitjes së këtij apartamenti. Për paralelizëm, mbështetur në udhëzimin e mësipërm të EKB-së të vitit 2010, duke qenë se mundëson çmimet e shitjes së apartamenteve në tregun e lirë për qytetin e Tiranës sipas zonave, një banesë me këtë sipërfaqe, 88,8 m², e ndodhur në qendër do të shitej në vlerën 11.544.000 lekë, ndërsa në zonën e “Porcelanit” do të shitej 5.328.000 lekë, sipas çmimit mesatar të të gjitha zonave në Tiranë, do të shitej në vlerën 8.436.000 lekë. Pra, siç konstatohet, diferenca në çmimin e shitjes në tregun e lirë, sipas të dhënave të EKB-së, ndikohet dukshëm nga vendndodhja e pasurisë së paluajtshme. Çmimi i shitjes së pasurisë të ndodhur në qendër është thujse dy herë më i lartë krahasuar me atë të ndodhur në periferi të qytetit dhe rreth 33% më i lartë nëse pasuria shitej me çmim mesatar të tregut të lirë. Nuk mund të ndëshkohet subjekti i rivlerësimit për mungesë të të dhënave statistikore të plota për qytetin në fjalë, lidhur me këtë tregues.

²⁸ Udhëzim nr. 3, datë 3.2.2010, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, për vitin 2010.

2.5. Së dyti, gjendja e pronës, ndërtim i ri në vitin 2006, punimet e kryera cilësore dhe mobilimi me mobilie të sjella nga vendi fqinj, nga kunati i tij, bëjnë që çmimi 60.000 euro të jetë në harmoni me logjikën ekonomike të tregut të lirë të apartamenteve, e mbështetur në vullnetin e lirë të palëve kontraktore, vullnet i paafektueshëm nga ndonjë qëllim ndryshe nga ai i formalizuar në kontratën e shitjes, hartuar në përputhje me ligjin.

2.6. Besueshmëria e vullnetit të shprehur në kushtet e kontratës së shitjes së kësaj pasurie, përforcohet nga fakti i deklarimit të saktë që subjekti i rivlerësimit ka bërë si në deklaratën e interesave privatë 2010, ashtu edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, në atë vlerë/çmim për të cilin **subjekti i rivlerësimit ka përmbushur detyrimin tatimor që i ngarkon ligji**. Deklarimi i shitjes së apartamentit në vitin 2010, në vlerën 60.000 euro, përputhet si në kohë, ashtu edhe në vlerë me deklarimin e përdorimit të kësaj shume, konkretisht: me shlyerjen e kredisë pranë Alpha Bank ShA, blerjen e automjetit “Mercedes Benz” sipas kontratës së shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.07.2010, dhe dhënien hua të shumës 38.000 euro në tetor 2010, shtetasit B. N., sipas deklaratës së vitit 2011.

2.7. Arsyetimi i Komisionit dhe i shumicës së trupit gjykues në Kolegj është i pabazuar në drejtim të konkludimit në deklaram të rremë lidhur me çmimin e shitjes së apartamentit objekt analizimi, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016, pasi në dosjen gjyqësore nuk ekziston dokument i administruar që të provojë pavërtetësinë e të dhënave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë *vetting*, krahasuar me deklaramet periodike vjetore të tij, të cilat janë në përputhje edhe me të dhënat e kontratave të lidhura, me përgjigjet përkatëse të bankave dhe ASHK-së së qytetit të Gjirokastrës. Në këto rrethana, mbetem e paqartë ku është konstatuar deklarimi i rremë nga shumica e trupit gjykues. Koncepti i deklarimit të rremë është i ndryshëm nga i konceptuari prej shumicës në këtë vendim dhe theksoj se neni i mësipërm është aplikuar në raste të tjera, për arsye e në rrethana të ndryshme nga rasti në fjalë. Koncepti i deklarimit të rremë në vetvete konsiston në shtrembërimin e fakteve, paraqitjen e të dhënave të rreme në deklarimet e bëra në deklaratat e depozituara në institucionin kontrollues, në mënyrë që të krijojë rrethana të pavërteta, por në rastin konkret, deklarimet e subjektit të rivlerësimit, pretendimet e tij në ankim dhe në parashtrime, referuar dokumentacionit, janë të vërteta, dhe përjashtojnë kështu aplikimin e kësaj dispozite. Unë, gjyqtarja në pakicë, mbështetur në bindjen time të brendshme, të krijuar në analizë të provave të administruara, dhe në interpretim të ligjit, kam çmuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë, në përputhje me ligjin, bazuar në dokumentacionin justifikues, ka qenë i vërtetë e i sinqertë në deklarimet e tij në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka qenë konsistent në këto deklarime dhe vlerësoj se nuk ka pasur indice për të kryer deklarim të rremë lidhur me këtë pasuri.

2.8. Për arsyet më lart, jam plotësisht kundër konkluzionit të shumicës për rastin në fjalë, duke shtuar se qëllimi i procesit të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, është i parashikuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 30 e vijues të ligjit nr. 84/2016, dhe ka të bëjë me identifikimin e subjekteve të rivlerësimit që kanë në pronësi apo përdorim më shumë pasuri nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht ato. Në kuptim të kësaj dispozite, subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në paligjshmëri **as sa i përket deklarimit e as justifikimit të burimeve financiare për**

krijimin e kësaj pasurie, gjë që bën të paaplikueshëm në këtë rast, nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për pamjaftueshmëri në deklarin e pasurisë. Në vlerësimin tim si gjyqtare në pakicë, deklarami i rremë jo vetëm duhet të vërtetohet si i tillë me dokument ligjor, por dhe në çdo rast, të shoqërohet me pamjaftueshmëri të burimeve financiare të ligjshme. Sa më sipër, konkluzioni i shumicës së trupit gjykues gjendet në kushtet e interpretimit të gabuar të dispozitës ligjore dhe është në kundërshtim me të gjitha aktet e administruara në cilësinë e provës në dosjen gjyqësore. Citoj këtu vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 41/2022, datë 31.10.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. E. K., paragrafët 23 dhe 24, në rastin e së cilës janë konstatuar dy kontrata shitblerjeje me të njëjtat ekstremite, me ndryshimin e vetëm çmimit e shitjes, i cili në kontratën e depozituar nga subjekti me deklaratën e pasurisë *vetting*, ishte më i lartë se çmimi i përcaktuar në kontratën që administrohej në AShK. Megjithatë, trupi gjykues në Kolegj ka konstatuar faktin, por nuk është shprehur për deklarin të rremë, por e ka lidhur këtë fakt vetëm me ligjshmërinë e burimeve, ndërkohë që në rastin konkret, shprehet për deklarin të rremë, edhe pse nuk e provon me dokumentacion.

3. Lidhur me pasurinë “apartament banimi” me sipërfaqe 126 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë:

3.1. Lidhur me konkluzionin e shumicës së trupit gjykues, se *mungesa e një kontrate dhe mosdeklarimi i çmimit të apartamentit nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “vetting”, si dhe pretendimet e tij janë të pamjaftueshme dhe jo të mbështetura në prova shkresore, për t’i bërë ato bindëse, në këto kushte gjendet me vend aplikimi i nenit 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016, për kryerjen e deklarin të rremë lidhur me çmimin e shitjes së kësaj pasurie:*

3.2. Në cilësinë e gjyqtarës në pakicë, jam plotësisht kundër konkluzionit të mësipërm dhe konstatoj se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit si gjatë hetimit administrativ në Komision, ashtu edhe në pretendimet e paraqitura në ankim, si dhe në parashtrimet në Kolegj, janë në përputhje të plotë me aktet e administruara në dosjen gjyqësore, të vërteta dhe, në vlerësimin tim, deklarinet e subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë pasuri, kanë qenë të sakta, në përputhje me ligjin. Këtë konkluzion e mbështes në arsyetimin në vijim.

3.3. Në deklaratën noteriale të datës 29.03.2011, me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., mes shtetasit B. N. dhe subjektit të rivlerësimit Shkëlqim Mustafa, është përcaktuar qartësisht dakordësia e tyre që shuma e dhënë hua, prej 38.000 eurosh, nga Shkëlqim Mustafa, do t’i kthehej nga B. N. brenda dy vjetësh në dy mënyra: ose cash, ose me shitjen e një apartamenti në pallatin që po ndërtohet në truallin e shtetasit B. N. në rr. “{***}”, Tiranë, nga shoqëria “{***}” ShPK. Për pjesën tjetër që do të paguhej për blerjen e apartamentit, ndërmjet tyre do të arrihej një marrëveshje mbasi të kishte përfunduar apartamenti. Kjo deklaratë noteriale rezulton e deklaruar si në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë 2010, ashtu edhe në deklaratën e pasurisë *vetting*.

3.4. Nga dokumentacioni i administruar, ka rezultuar se më datë 19.09.2006, nënshkruhet kontrata e sipërmarrjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., mes pronarëve të truallit B. e E. N. dhe shoqërisë sipërmarrëse “{***}” ShPK, me objekt ndërtimin e një godine banimi, ku sipas kontratës, pronarët e truallit do të përfitonin 40% të sipërfaqes së ndërtimit, dhe në favor të subjektit ndërtues “{***}” ShPK, është dhënë leja për ndërtimin: “Godinë banimi dhe

shërbime 6, 8 dhe 9 kate, me dy kate parkim nëntokë”, në rrugën “{***}”, Tiranë, me afat 34 muaj, në pronë të disa familjeve, përfshirë dhe familjen N..

3.5. Më datë 28.08.2010, mes B. dhe E. N. dhe shoqërisë sipërmarrëse “{***}” ShPK, nënshkruhet kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., “Për përcaktimin e pjesëve që përfiton nga ndërtimi”, nëpërmjet së cilës familja N., në bazë të përlllogaritjeve, do të përfitonte 1232,21 m² sipërfaqe totale ndërtimi. Në apartamentet e banimit që do të merreshin nga pronarët e truallit, rezultojnë edhe apartamenti objekt shqyrtimi, me sipërfaqe 122,66 m², i ndodhur në katin e katërt, që nga komunikimi me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë-Veri, rezultojnë ende në pronësi të shoqërisë “{***}” ShPK.

3.6. Për nevojat e hetimit, Komisioni i është drejtuar shoqërisë “{***}” ShPK, e cila informon se është në konflikt gjyqësor me pronarin B. N.. Sipas dokumentacionit, familja N. ka paraqitur përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, kërkesëpadi me objekt, ndër të tjera, detyrimin e të paditurit, shoqërisë “{***}” ShPK, për zbatimin e kontratës nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.02.2010, dhe sigurim padie e pezullim të të gjitha veprimeve e transaksioneve në ZVRPP Tiranë, lidhur me këtë pasuri. Me vendimin nr. {***} akti, datë 01.04.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka pranuar kërkesën për sigurimin e padisë, duke vendosur bllokimin e çdo veprimi ligjor për tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme “Pallat” në rr. “{***}”, Tiranë, i regjistruar në emër të shoqërisë “{***}” ShPK, deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendim nr. {***}, datë 03.04.2015, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***} akti, datë 01.04.2014, me ndryshimin që sigurimi i padisë duhet t’i shtrijë efektet jo mbi të gjithë pallatin e regjistruar në emër të shoqërisë “{***}” ShPK, por vetëm për aq sa palët kanë rënë dakord në kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 28.08.2010, objekt konflikti. Sipas dokumentacionit në dosje, ka rezultuar e provuar se konflikti i pronarëve N. me shoqërinë sipërmarrëse ka agravuar me proceset e tjera që kanë vijuar mes tyre, të karakterit civil, administrativ dhe penal dhe ka rezultuar se proceset gjyqësore lidhur me pronat e përcaktuara sipas kontratës së lidhur më datë 28.08.2010, mes B. e E. N. dhe shoqërisë sipërmarrëse “{***}” ShPK, kanë vazhduar deri në vitin 2018.

3.7. Ndodhur në këtë situatë faktike, unë, gjyqtarja në pakicë, çmoj se konkluzioni i shumicës lidhur me mosdeklarimin në deklaratën e pasurisë *vetting* të çmimit të apartamentit nga subjekti i rivlerësimit, është i gabuar, në kundërshtim me provat e administruara në dosje dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

3.8. Duke iu referuar deklaratës noteriale të sipërcituar, kuptohet qartë se dhënia e huas nuk ka pasur për qëllim blerjen e një apartamenti ose pagimin e një kësti, ku detyrimisht nga subjekti i rivlerësimit dhe B. N. duhet të ishte lidhur të paktën një aktmarrëveshje, ku të ishte përcaktuar vlera totale e apartamentit dhe mënyra e likuidimit të tij, por referuar deklaratimeve të subjektit, i cili ka pasur njohje të vjetra me pronarët e truallit që në kohën kur subjekti ishte student dhe në vazhdim, i ka dhënë këtë hua sipas deklaratimit, në tetor të vitit 2010, që përkon me shitjen e apartamentit në qytetin e Gjirokastrës dhe e deklaruar në vitin korrent përkatës, nga ana e subjektit. I transferuar për shkak të detyrës, ka filluar të banojë në këtë apartament prej datës 18 nëntor 2012, duke pritur regjistrimin e këtij apartamenti në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, dhe më pas ofrimin e këtij apartamenti si koletaral/garanci

hipotekare për marrjen e një kredie, kjo sipas deklaratës së pasurisë *vetting*. Konfliktet gjyqësore që vazhduan si analizuar më sipër, bënë që situata të degradonte në mënyrë të tillë, jashtë vullnetit të subjektit, deri në pikën që subjekti e kishte të pamundur të kryente një veprim juridik lidhur me këtë pasuri, pasi këto konflikte gjyqësore kanë vijuar prej fillimit të vitit 2014 deri në vitin 2018, për pasuritë e caktuara në kontratën e nënshkruar mes shoqërisë sipërmarrëse dhe pronarëve të truallit në vitin 2010, ku përfshihet edhe apartamenti i subjektit të rivlerësimit.

3.9. Nga sa analizuar më sipër, rezulton që apartamenti i ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, të jetë në posedim nga subjekti i rivlerësimit prej datës 18.11.2012, dhe nëse e trajtojmë këtë situatë sipas nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, në rrethana të tilla ku subjekti i rivlerësimit posedon një pasuri për një kohë të gjatë, ka detyrimin ta deklarojë saktësisht përdorimin e pasurisë dhe burimin e krijimit të saj, çmoj se deklaratimet e subjektit nuk bien ndesh me asnjë provë të administruar nga palët në këtë proces, si nga shoqëria, ato të administruara nga Komisioni, ashtu edhe nga vetë subjekti. Për këtë arsye, kam krijuar bindjen se situata ligjore e krijuar me pronën objekt trajtimi në këtë rast, është jashtë vullnetit të subjektit, ndërsa deklaratimet e tij janë në përputhje me provat e administruara. Situata juridike e pronës apartament banimi, masa e sigurimit e dhënë nga gjykata, e cila ka qëndruar për një kohë të gjatë deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes në Gjykatën e Lartë, ka penguar subjektin për të kryer veprime juridike me këtë pronë, pasi masa e sigurimit ka si qëllim të ruajë gjendjen aktuale të objektit të padisë deri në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me vendim të formës së prerë dhe, sipas vendimeve të gjykatës, ka rezultuar se situata faktike e pronës së familjes N. ka ndryshuar, duke u reduktuar edhe në sipërfaqe.

3.10. Ndodhur në këtë situatë faktike ligjore, ku rrethanat e faktit nuk kanë lidhje me vullnetin e subjektit, ose të jenë sajuar prej tij për efekt të procesit të rivlerësimit, por janë rrethana të krijuara nga pronarët e truallit dhe shoqëria ndërtuese/sipërmarrëse, subjekti ka qenë korrekt në deklaratimet e tij, në shpjegimet e dhëna përgjatë hetimit administrativ në Komision, në përputhje me përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës që e ngarkon subjektin me përgjegjësinë për paraqitjen në mënyrë të saktë të pasurisë në pronësi, posedim ose në përdorim, kështu që konkluzioni i shumicës është i gabuar dhe në kundërshtim me aktet e administruara në dosje, prandaj jam kundër konkluzionit të saj për këtë pasuri.

4. Lidhur me pasurinë automjet, i markës “Mercedes Benz”, tip “ML 350 CDI 4MATIC”:

4.1. Ashtu sikundër edhe shumica është shprehur në paragrafin 17.9 të vendimit, nga analizimi i akteve në dosjen gjyqësore, është provuar se automjeti është blerë nga nipi i subjektit I. M., është regjistruar në pronësi të këtij shtetasi më datë 16.09.2014, dhe më datë 17.09.2014 autorizohet subjekti i rivlerësimit për përdorimin e këtij mjeti, ndërkohë nga analizimi i dokumentacionit financiar të administruar, B. Xh. dhe I. M. rezultojnë me të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për blerjen e automjetit, dhe nuk mund të konkludohet që automjeti “Mercedes Benz”, tip “ML 350 CDI”, vit prodhimi 2011, është pasuri e fshehur e subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që ai deklaroi se nuk kishte nevojë të përdorte këtë automjet pasi dispononte mjetin e tij me targë {***}. Për më tepër që sot automjeti “Mercedes Benz” është në shtetin anglez, pranë pronarit të tij.

- 4.2. Për sa i përket mosdeklarimit për aq kohë që subjekti e ka përdorur, çmoj se duhet ta kishte deklaruar sipas kërkesave të ligjit. Në rastin konkret, pavarësisht se subjekti nuk e ka deklaruar përdorimin e automjetit, nga dokumentacioni në dosjen gjyqësore, provohet që ky automjet nuk është një pronësi e fshehur e tij, dhe se subjekti nuk është përpjekur të fshehtë qëllimisht këtë pasuri në përdorim për t'u klasifikuar sipas përcaktimeve të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.
5. Nga analizimi i shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, për secilën nga çështjet e trajtuara më sipër, në raport me aktet në dosjen gjyqësore, rezulton se subjekti i rivlerësimit në asnjë rast nuk ka pasur tendencë të jetë i pasinqertë në kuadër të këtij procesi.
6. Në konkluzion të sa më sipër, vlerësoj se provat e administruara, në harmoni me faktet e provuara prej tyre, më krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa "b" e ligjit nr. 84/2016, shumica e trupit gjykues duhet të dispononte me ndryshimin e vendimit nr. 333, datë 13.01.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Shkëlqim Mustafa.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi